



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:**

**“Fizioterapi”**

**Universiteti “ALDENT”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Asoc. Fatjona Kamberi**

**Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli**

**Dhjetor / 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Bachelor në “Fizioterapi”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aldent”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Fizioterapi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr. 519, datë 19.11.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 11, datë 29.01.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 36, datë 13.07.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022 25 PAE / 9 PAK; 2022-2023 26 PAE / 8 PAK; 2023-2024 28 PAE / 9 PAK;
18	Numri i studentëve:	2021-2022 49 studentë; 2022-2023 31 studentë; 2023-2024 29 studentë;
19	Komente / të tjera:	-




## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti Aldent (UAL) është një Institucion jo publik i Arsimit të Lartë. Universiteti Aldent funksionon që prej vitit 2006 (VKM Nr. 673, datë 27.09.2006) si Institucion i pavarur duke ofruar programe studimi në fushat mjekësore. Universiteti Aldent është një institucion i arsimit të lartë jo publik me një përvojë rreth 20 vitesh në fushën e edukimit në Shqipëri. Institucioni ka zhvilluar një profil të rëndësishëm në arsimin e lartë, duke qëndruar për ofrimin e standardeve më të larta në mesimdhënie dhe aktivitete të tjera akademike dhe shkencore. Universiteti Aldent është hapur me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 27.09.2006 dhe është akredituar për herë të fundit me VBA Nr. 01, datë 27.01.2023. Universiteti Aldent ka në përbërjen e vet tre (3) Njësi Kryesore dhe nëntë (9) Njësi Bazë, nga të cilat tre Qendra, (një në çdo Njësi Kryesore). Këto Njësi ofrojnë në total 11 programe studimi në dy ciklet. Njësitë Kryesore të Universitetit Aldent, janë:

- Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
- Fakulteti i Shkencave Dentare;

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ku ofrohet dhe programi i studimit Bachelor në Fizioterapi, ka në përbërjen e vet:

- Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë;
- Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri;
- Qendra e Promovimit të Shëndetit;

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ofron programin e studimit Bachelor në Fizioterapi. Paralelisht, kjo Njësi ofron dhe programe të tjera në këtë fushë përfshirë programin Bachelor në Infermieri, Master Shkencor në Fizioterapi Klinike dhe Master Shkencor në Infermieri Klinike. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë i cili ofron këtë program studimi ka në përbërjen e vet 22 (0 Prof. Dr., 4 Prof. Assoc., 5 Dr., 1 Dr. në proces dhe 12 MSc.) personel akademik PAE dhe 20 personel akademik me kontratë (1 Prof. Dr., 1 Prof. Assoc., 7 Dr., dhe 11 MSc.). Njësia Bazë nuk ka staf ndihmës akademik.

Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi ofrohet që prej vitit 2010 bazuar në Urdhërin MASH Nr. 519, datë 19.11.2010. Programi i studimit është akredituar për herë të parë me vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 326, datë 07.08.2012 dhe më vonë me vendimin Nr. 36, datë 13.07.2018.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi” që ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, në Universitetin Aldent, filloi me marrjen e dokumentacionit të ofruar nga Intitucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Aldent, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Në kuadër të procesit të jashtëm të vlerësimit është përgatitur agjenda nga ASCAL dhe është kryer vizita në datat 11 – 12 Prill 2024. Dy ekspertët e përzgjedhur shoqëroheshin nga një specialist i ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm kishte në përbërje **Prof. Asoc. Fatjona Kamberi** dhe **Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Znj. Majlinda Demireli.

Bazuar në agjendën e përgatitur nga ASCAL u zhvilluan takimet me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë, grupin e vlerësimit të brendshëm, anëtarë të stafit akademik (efektiv dhe me kontratë) dhe studentët. Paralelisht, ditën e parë u zhvillua dhe takimi me përfaqësues të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.

Ditën e dytë, GVJ zhvilloi takime me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Komisionit të Përhershëm në fushën e kurrikulave dhe standardeve dhe Komisionit të Përhershëm në fushën e kërkimit shkencor, përfaqësues të Zyrës së Informacionit dhe Pranimit të Studentëve si dhe zhvilloi vizitë në sekretarinë mësimore. Paralelisht, u zhvillua vizita në në ambientet e Fakultetit. Gjatë vizitës në Institucion u panë klasa, laboratorë të ndryshëm si dhe biblioteka. Kohëzgjatja e takimeve ishte ajo e parashikuara. Me përfundimin e takimeve, GVJ takoi Drejtuesen e Departamentit ndërsa eksperti i ASCAL do të informonte koordinatoren Institucional mbi disa dokumenta shtesë. Në përfundim të vizitave, ekspertët në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, takimeve të zhvilluara si dhe vizitës në ambientet e Institucionit hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti “ALDENT” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 12.11.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 127/7 Prot, datë 13.11.2024. Universiteti “ALDENT”, njofton më datë 19.11.2024, nëpërmjet shkresës me nr. 16/3, prot, datë 18.11.2024, “*Kthim përgjigje për Draft RVJ e programit të studimit Bsc në “Fizioterapi”*”.

*Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

1. Lidhur me komentin e parë, GVJ e konsideron se ngritja e një klinike të tillë pranë ALDENT në një periudhë afatmesme/afatgjatë do të kontriboj në rritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së IAL-së. Theksojmë se, ngritja e kësaj klinike ka qenë një nga rekomandimet e raportit të kaluar të vlerësimit. Megjithatë, ofrimi i këtyre shërbimeve në bashkëpunim me klinika të ndryshme është një pikë e fortë të cilën GVJ e ka përmendur dhe në draft raportin e përgatitur. GVJ mendon se përgatitja e studentëve

përmes bashkëpunimit me klinikat private është në nivel të mjaftueshëm. Një sugjerim mund të jetë dhe ngritja e klinikës në kuadër të thirrjeve për projekte në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në partneritetet pse jo edhe me klinikat private me të cilat ALDENT aktualisht bashkëpunon në këtë drejtim. **Nuk ka ndryshime në raport.**

2. Lidhur me **komentin e dytë**, GVJ i konsideron të rëndësishme dhe pozitive hapat e ndërmarra nga IAL-ja për adresimin e disa nga pikave të diskutuara gjatë vizitës në Institucion. **Nuk ka ndryshime në raport.**
3. Lidhur me **komentin e tretë**, GVJ falenderon Institucionin për sqarimin mbi stafin ndihmës akademik me karakter akademik në nivel Njësie Kryesore, si dhe ndjekjen e studentëve gjatë praktikave nga asistent lektorët e fizioterapisë (ekspertë të njohur të fushës). **Raporti ndryshon.**
4. Lidhur me **komentin e katërt**, GVJ falenderon Institucionin për sqarimin e procedurës së përditësimit të syllabusit, por GVJ e konsideron të rëndësishëm dhe inkurajon IAL-në, në standartizimin e këtij procesi dhe dokumentimin e rregullt të këtij procesi. **Nuk ka ndryshime në raport.**
5. Lidhur me **komentin e pestë**, GVJ falenderon Institucionin për sqarimin, por GVJ e konsideron të rëndësishme hartimin e një rregullore të tillë me qëllim njohjen e detajuar të studentëve për detyrimet përfundimtare. Gjithësesi, përfshirja e këtij informacioni në rregulloret aktuale është i mjaftueshëm. **Nuk ka ndryshime në raport.**
6. Lidhur me **komentin e gjashtë**, GVJ vlerëson pozitivisht organizimin e aktiviteteve të tilla. Në këtë kuadër, konsiderojmë se organizimi i sa më shumë aktiviteteve të tilla në vazhdimësi me në fokus studentët e këtij programi studimi (Bachelor në Fizioterapi), është e nevojshme. **Nuk ka ndryshime në raport.**

## **SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT**

### **I. Rekomandimi i Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.36, datë 13.07.2018 është:**

1. Institucioni të mbajë në vëmendje në të ardhmen ngritjen e një klinike fizioterapeutike, e cila mund të ofrojë shërbim ndaj të tretëve dhe do të sillte shumëllojshmëri të rasteve klinike për tu analizuar nga studentët.

### **II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni**



UAL nuk ka ngritur ende një klinikë të mirëfilltë fizioterapeutike me qëllim ofrimin e shërbimeve ndaj të tretëve. Autoritetet drejtuese raportuan se ngritja e një klinike Fizioterapeutike është ende një problem. Ata janë munduar të rrisin e bashkëpunimet me klinika private në të cilat studentët ofrojnë shërbime. UAL është munduar të ndihmoj këto klinika përmes ofrimit të materialeve të ndryshme shërbimeve nëpërmjet studentëve. Autoritetet drejtuese raportuan se pozicioni i UAL-së nuk u jep atyre shumë mundësi për të ndërtuar një klinikë të tillë dhe për të ofruar këto shërbime. UAL konsideron se rritja e numrit të bashkëpunimeve me klinikat private ku studentët zhvillojnë praktikat e tyre si dhe përmirësimi i infrastrukturës aktuale i përgatit ata dhe i aftëson më së mirë për të ofruar shërbime fizioterapeutike. Gjithashtu, ata raportuan se përmes Klinikës së Stomatologjisë dhe Qendrës së Formimit dhe Shërbimit ofrojnë shërbime të ndryshme. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni si dhe diskutimet e zhvilluara në UAL, GVJ konsideron se UAL duhet të rrisë përpjekjet për të gjetur mekanizmat e duhur, bazuar edhe në praktikat aktuale, nevojat e komunitetit dhe sugjerimet e studentëve dhe stafit akademik për të krijuar një klinikë fizioterapeutike me qëllim ofrimin e shërbimeve ndaj të tretëve. GVJ konsideron se ky rekomandim është **përmbushur kryesisht.**



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Fizioterapi"

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti Aldent (UAL) është një Institucion jo publik i Arsimit të Lartë. Universiteti Aldent funksionon që prej vitit 2006 (VKM Nr. 673, datë 27.09.2006) si Institucion i pavarur duke ofruar programe studimi në fushat mjekësore. Universiteti Aldent është një institucion i arsimit të lartë jo publik me një përvojë rreth 20 vitesh në fushën e edukimit në Shqipëri. Institucioni ka zhvilluar një profil të rëndësishëm në arsimin e lartë, duke qëndruar për ofrimin e standardeve më të larta në mesimdhënie dhe aktivitete të tjera akademike dhe shkencore. Aldent është hapur me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 27.09.2006 dhe është akredituar për herë të fundit me VBA Nr. 01, datë 27.01.2023, sipas nenit 6 të Statutit të Universitetit, Aldent angazhohet të përmbushë të gjitha detyrimet që burojnë nga Ligji, aktet nënligjore me të gjitha palët dhe në të gjitha marrëdhëniet e ligjshme.</p> <p><b>Evidenca:</b> <i>Statuti i Universitetit Aldent;</i> <i>Rregullore e Universitetit.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi që ofrohet nga IAL Aldent, është në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit. UAL ka për qëllim: a) të ofrojë studime universitare në cikle të ndryshme, të bazuara në kërkim dhe njohuri shkencore, për të përgatitur profesioniste, specialistë dhe shkencëtarë të rinj. b) në kuadrin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, ka për qëllim të ofrojë gjithashtu programe studimi afatshkurtra për kualifikime e specializime, si dhe për përditësimin e dijeve të fituara. Veprimtaritë kryesore të Universitetit "Aldent" janë mësimi, puna shkencore, shërbimi për studentet dhe publikun e gjerë. Procesi mësimor zhvillohet në bazë të planeve dhe programeve të studimit të hartuara nga specialistët përkatës, të miratuara nga strukturat akademike të saj si dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Këshilli i</p>

	<p>Akreditimit dhe Agjensia e Sigurimit të Cilesise pre Arsimin e Larte (ASCAL). Puna kërkimore orientohet në funksion të kualifikimit të stafit akademik dhe problemeve që ka jeta shoqërore e vendit. Vizioni i UAL është krijimi i një institucioni të arsimit të lartë cilësor, i cili ofron një sistem vlerash profesionalizmi dhe qytetarie duke synuar që nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor të përgatise profesionistë të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv në përputhje me strategjinë e zhvillimit kombëtar.</p> <p>Programi i studimit "Bachelor" në "Fizioterapi" ka përcaktuar si mision të tij: a) Të përgatisë studentë me njohuri të bazë të rehabilitimit b) Të përgatisë studentë me njohuri mbi ekzaminimin klinik, diagnostifikimin dhe ngritjen e protokolleve fizioterapeutike afatshkurtër dhe afatgjatë c) Të përgatisë studentë që zotërojnë sa më shumë metoda dhe teknologji moderne të fizioterapisë d) Të përgatisë studentë të cilët kanë njohuri të plota mbi diagnoza neurologjike, ortopedike, pediatrike, reumatologjike, interne etj. në grupmosha të ndryshme e) Të përgatisë studentët të trajtojnë pacientët më problematika posturale f) Të përgatisë studentë të cilët do dijnë të ndërveprojnë në një grup multidisiplinor g) Të përgatisë studentët të aftë për të konkuruar në tregun vendas dhe të huaj h) Të kontribuojë në zhvillimin, emancipimin dhe rritjen e standardeve të shkencës së fizioterapisë duke përgatitur të rinjtë për të qenë pjesë e denjë e saj.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>Strategjia i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit;</i></p> <p><i>Rregullore e programit Ba në Fizioterapi.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.</p>	<p>Drejtuësit e Universitetit "Aldent" vazhdojnë të jenë besnik të vizionit të tyre fillestar: "Një institucion i arsimit të lartë dedikuar vetëm shkencave mjekësore dhe që rritet hap pas hapi. Sipas strategjisë së Aldent, misioni i Universitetit përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ofrimin e arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese për studentët në fushën mjekësore me qëllim realizimin e synimeve të tyre profesionale brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë;</li> <li>2) Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike;</li> </ol>








	<p>3) Formimin e studiuesve të rinj në fushat mjekësore, nëpërmjet programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik;</p> <p>4) Thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialisteve të lartë në fushat mjekësore, duke ofruar mundësi të mira për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit giatë gjithë jetës;</p> <p>5) të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit;</p> <p>6) të bashkëpunoj me Universitete të tjera jashtë vendit apo me firma e kompani të ndryshme prodhuese ndërkombëtare në fushën e mjekësisë. Rregullorja e programit të studimit është e bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UAL ndërsa programi i studimit ofrohet në përputhje me Strategjinë e zhvillimit. Kjo u konfirmua dhe në takimet e zhvilluara me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>Strategjia i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit;</i></p> <p><i>Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti Aldent (UAL) është një Institucion jo publik i Arsimit të Lartë. Universiteti Aldent funksionon që prej vitit 2006 (VKM Nr. 673, datë 27.09.2006) si Institucion i pavarur duke ofruar programe studimi në fushat mjekësore. Universiteti Aldent është një institucion i arsimit të lartë jo publik me një përvojë rreth 20 vitesh në fushën e edukimit në Shqipëri. Institucioni ka zhvilluar një profil të rëndësishëm në arsimin e lartë, duke qëndruar për ofrimin e standardeve më të larta në mesimdhënie dhe aktivitete të tjera akademike dhe shkencore. Aldent është hapur me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 27.09.2006 dhe është akredituar për herë të fundit me VBA Nr. 01, datë 27.01.2023. Universiteti Aldent ka në përbërjen e vet tre (3) Njësi Kryesore dhe nëntë (9) Njësi Bazë, nga të cilat tre Qendra, (një në çdo Njësi Kryesore). Këto Njësi ofrojnë në total 11 programe studimi në dy ciklet.</p>




	<p>Njësia kryesore që ofron këtë program studimi në vitin akademik 2023 – 2024, ka në total 100 staf akademik nga të cilët 49 personel akademik efektiv (PAE) dhe 51 staf akademik me kontratë (PAK).</p> <p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë i cili ofron këtë program studimi në vitin akademik 2023 – 2024, ka në përbërjen e vet 22 (0 Prof. Dr., 4 Prof. Assoc., 5 Dr., 1 Dr. në proces dhe 12 MSc.) personel akademik PAE dhe 20 personel akademik me kontratë (1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc., 7 Dr., dhe 11 MSc.).</p> <p>Institucioni demonstron se ka kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij programi studimi. Aldent është akredituar më herët. Infrastruktura në funksion të mësimdhënies është e mjaftueshme për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi. Një pikë e fortë e UAL-së është plotësimi i kuotave në këtë program studimi, gjë që vin si pasojë edhe të eksperiencës dhe kapaciteteve të Institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>Strategjia i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit;</i></p> <p><i>Relacion infrastrukture;</i></p> <p><i>Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>Përshkrim i laboratoreve në funksion të programit;</i></p> <p><i>Tabelat e të dhenave të Fizioterapisë (Tabelat 2-5);</i></p> <p><i>Program i përmbledhur;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Vizita në ambientet e UAL.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit</p>	<p>Universiteti Aldent është institucion i cili ofron programe studimi vetëm në fushën e shkencave Mjekësore. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT) i cili ofron këtë program studimi, ka në përbërjen e vet Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë; Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imaxheri; dhe Qendra e Promovimit të Shëndetit. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ofron programin e studimit Bachelor në Fizioterapi. Paralelisht, kjo Njësi ofron dhe programe të tjera në këtë fushë përfshirë programin Bachelor në Infermieri, Master Shkencor në Fizioterapi Klinike dhe Master Shkencor në Infermieri Klinike. Institucioni në</p>

<p>sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>bazë të urdhërit të MAS ka përcaktuar kodifikimin e programeve të studimit (Kodifikimi i programit është propozuar dhe dërguar në MAS, bazuar në Klasifikimin Standard të Arsimit KSNA 2011 dhe Fushat e Arsimit dhe Trajnimit KSNA-së) dhe është në pritje të përfundimit të procesit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>Strategjia i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit;</i></p> <p><i>Tabelat e te dhenave te Fizioterapise (Tabela 1);</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAL ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi që ofrohet nga Universiteti Aldent, është në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit. Programi i studimit "Bachelor" në "Fizioterapi" ka përcaktuar si mision të tij të përgatisë studentë me njohuritë bazë të rehabilitimit. Rregullorja e programit të studimit është e bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UAL ndërsa programi i studimit ofrohet në përputhje me Strategjinë e zhvillimit.</i></p> <p><i>Njësia kryesore që ofron këtë program studimi ka të gjitha kapacitetet e nevojshme (njerëzore dhe infrastrukture) për ofrimin e programit të studimit ndërsa Universiteti Aldent është institucion i cili ofron programe studimi vetëm në fushën e shkencave Mjekësore. Kodifikimi i programit është propozuar dhe dërguar në MAS, bazuar në Klasifikimin Standard të Arsimit KSNA 2011 dhe Fushat e Arsimit dhe Trajnimit KSNA-së.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UAL në zbatim të dispozitave ligjore ka të hartuar dhe miratuar statutin e vet (miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 49, datë 31.10.2023) dhe rregulloren e vet. Neni 8 i statutit dhe neni 3 i Rregullores përcaktojnë organigramën dhe strukturën akademike dhe administrative të UAL. Detyrat e secilit organ/sector/autoritet përcaktohen në Statut, Rregullore si dhe në akte të tjera. Organigrama e Institucionit përcakton Njësitë Akademike dhe jo akademike. Secila Njësi si dhe organet e ndryshme kanë hartuar rregulloret e veta të cilat zbatohen (sipas raportimeve në takimet e zhvilluara). Në UAL janë të përfshira Njësi Kryesore, njësi Bazë, Njësi Administrative si dhe Komisione të përhershme. Të gjitha këto njësi bashkëpunojnë më njëra tjetrën në bazë të detyrave të përcaktuara. Kjo u konfirmua dhe në takimet e zhvilluara në IAL ndërsa autoritetet drejtuese theksuan faktin që ofrohen në department katër (4) programe studimi të cilat funksionojnë shumë mirë.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>Strategjia i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit;</i></p> <p><i>Rregullore e FSHMT;</i></p> <p><i>Rregullore e NJSBC;</i></p> <p><i>Rregullore e Sekretarisë;</i></p> <p><i>Rregullore e Senatit studentor</i></p> <p><i>Rregullore e Burimeve Njerëzore;</i></p> <p><i>Takimet me përfaqësues të njësive të ndryshme në UAL.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Siaps statutit të UAL, për përmbushjen e qëllimit të tij, institucioni mund të bashkëpunojë e të lidhë marrëveshje me ente publike e private për veprimtari të përbashkëta didaktike, kërkimi, të konsulencës e shërbimeve në favor të të tretëve. UAL angazhohet në promovimin, organizimin dhe realizimin e shërbimeve kulturore e formuese ne territor rajonal e kombëtar. UAL raporton se bashkëpunon ngushtë me Universitetin e Mjekësisë në Tiranë bazuar dhe në eksperiencën e tyre në këtë fushë. Bashkëpunimi me institucione të ndryshme fokusohet në shkëmbimin e stafit dhe studentëve, organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, zhvillimin e praktikave mësimore etj.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Statuti i Universitetit Aldent;</i></p>





	<p><i>Tabelat e te dhenave te Fizioterapise (Tabela 20);</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p> <p><i>Aldent University and Acibadem University MOU;</i></p> <p><i>Ankara University;</i></p> <p><i>Marreveshje ALBMEDTECH;</i></p> <p><i>Marreveshje me QSUT;</i></p> <p><i>MARREVESHJE ME TRAUMEN;</i></p> <p><i>MARREVESHJE UAL-MJEKESI;</i></p> <p><i>Marrveshja me Istynie University.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>UAL me qëllim realizimin e programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi” ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me spitale publike përfshirë këtu QSUNT, Spitalin e Traumës, Spitalin Shefqet Ndroqi etj. Paralelisht, ka një numër të lart marrëveshjesh me klinika private fizioterapeutike në të cilat studentët mund të kryejnë praktikë mësimore, praktikë profesionale etj. Këto u konfirmuan dhe në takimin e zhvilluar me autoritetet drejtuese dhe studentët e programit të studimit. GVJ e konsideron numrin e bashkëpunimeve me klinika private për realizimin e praktikave mësimore si një pikë të fortë të UAL.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Marreveshje bashkëpunimi me klinikat fizioterapeutike;</i></p> <p><i>Tabelat e te dhenave te Fizioterapise (Tabela 20);</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p> <p><i>Aldent University and Acibadem University MOU;</i></p> <p><i>Ankara University;</i></p> <p><i>Marreveshje ALBMEDTECH;</i></p> <p><i>Marreveshje me QSUT;</i></p> <p><i>MARREVESHJE ME TRAUMEN;</i></p> <p><i>MARREVESHJE UAL-MJEKESI;</i></p> <p><i>Marrveshja me Istynie University.</i></p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Koordinatori i programit të studimit harton raporte mbi ecurinë e programit të studimit. Në bashkëpunim me përfaqësues të Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë raporton dhe mbi ecurinë e implementimit të marrëveshjeve të cilat janë në funksion të programit Bachelor në “Fizioterapi”.</p> <p><i>GVJ konsideron se këto raporte duhet të jenë më analitike mbi ecurinë e marrëveshjeve, përfitimet, pengesat si dhe hapat që duhet të ndërmerren në të ardhmen.</i></p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>22. Raport i koordinatorit të programit model;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njësisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njësisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me përfaqësues të Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Neni 8 i statutit dhe neni 3 i Rregullores përcaktojnë organigramën dhe strukturën akademike dhe administrative të UAL. Detyrat e secilit organ/sector/autoritet përcaktohen në Statut, Rregullore si dhe në akte të tjera. Siaps statutit të UAL, për përmbushjen e qëllimit të tij, institucioni mund të bashkëpunojë e të lidhë marrëveshje me ente publike e private për veprimtari të përbashkëta didaktike, kërkimi, të konsulencës e shërbimeve në favor të të tretëve.</i></p> <p><i>UAL me qëllim realizimin e programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi” ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me spitale publike dhe me klinika private fizioterapeutike. GVJ e konsideron numërin e bashkëpunimeve me klinika private për realizimin e praktikave mësimore si një pikë të fortë të UAL. Koordinator i programit të studimit harton raporte mbi ecurinë e programit të studimit. GVJ konsideron se këto raporte duhet të jenë më analitike mbi ecurinë e marrëveshjeve, përfitimet, pengesat si dhe hapat që duhet të ndërmerren në të ardhmen.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ky është një program studimi i ciklit të parë (niveli 6 i kualifikimeve sipas përcaktimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve) me total 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike. Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite. Secila lëndë/modul ka të përcaktuar kreditet e veta. Ndarja e krediteve për secilën lëndë/modul dhe secilin component të mësimdhënies pasqyrohet në planin mësimor (neni 8 i Rregullores së programit të studimit).</p> <p>Gjatë një vit studenti mund të përfitoj deri në 60 kredite (neni 32 i Rregullores së UAL).</p> <p>Një kredit është i barabartë me 25 orë mësimore ndërsa krediti shpreh punën Brenda dhe jashtë auditorit që është e nevojshme për përvetësimin e lëndës nga student (neni 21 i Rregullores së Fakultetit).</p> <p>Sipas nenit 21 të Rregullores së UAL, veprimtarite formuese, që karakterizojnë një program studimi, janë leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, praktikat profesionale, projektet e kursit. Format kryesore të kontrollit të dijeve janë kolokiumet, provimet e sesioneve, temat e diplomimit dhe provimi i diplomimit. Mënyra të tjera mund të miratohen me vendime të brendshme të Njësisë Kryesore.</p> <p>Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme: a. lëndë bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme; b. lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore; c. lëndë ndërdisiplinore/integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje; d. lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale; e. detyrime përmbyllëse. Në programin e studimit Bachelor në Fizioterapi, parashikohen lëndët dhe modulet si dhe kreditet për secilën lëndë/modul. Në përgjithësi, sipas planit mësimor, parashikohen 32.5 kredite për lëndët bazë (18%), 92 kredite për lëndët karakterizuese (51%), 25 kredite për lëndët</p>




	<p>ndërdisiplinore (14%), 23.5 kredite për lëndët plotësuese (13%) dhe 7 kredite për detyrimet përmbyllëse (4%).</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit;</i></p> <p><i>Rregullore e FSHMT;</i></p> <p><i>Rregullore e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi;</i></p> <p><i>Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabelat 11-12);</i></p> <p><i>24. Program i permbledhur.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit "Bachelor" ne "Fizioterapi" ka përcaktuar si mision të tij: a) Të përgatisë studentë me njohuritë bazë të rehabilitimit b) Të përgatisë studentë me njohuritë mbi ekzaminimin klinik, diagnostifikimin dhe ngritjen e protokolleve fizioterapeutike afatshkurtër dhe afatgjatë c) Të përgatisë studentë që zotërojnë sa më shumë metoda dhe teknologji moderne të fizioterapisë d) Të përgatisë studentë të cilët kanë njohuri të plota mbi diagnoza neurologjike, ortopedike, pediatrike, reumatologjike, interne etj. në grupmosha të ndryshme e) Të përgatisë studentët të trajtojnë pacientët më problematika posturale f) Të përgatisë studentë të cilët do dijnë të ndërveprojnë në një grup multidisiplinar g) Të përgatisë studentët të aftë për të konkuruar në tregun vendas dhe të huaj h) Të kontribuojë në zhvillimin, emancipimin dhe rritjen e standardeve të shkencës së fizioterapisë duke përgatitur të rinjtë për të qenë pjesë e denjë e saj.</p> <p>Objektivat dhe kurrikula e programit Bachelor në Fizioterapi janë përgatitur për t'ju ofruar studentëve njohuri të thella dhe të plota mbi punën, parimet dhe metodikën e punës në specialitetin e fizioterapisë, në mënyrë që studentët të përfitojnë një formim të plotë duke u aftësuar në shkencën rehabilituese. Sipas RVB Programi Bachelor ne Fizioterapi synon:</p> <p>1) të formojë të diplomuarit fizioterapeut si profesionistë të cilët do të luajnë një rol të rëndësishëm në cilësinë e rehabilitimit fizioterapeutik dhe sigurinë e pacientit. Ata do të jenë zgjedhja e parë si partnerë për punë ndërdisiplinore në kujdesin ndaj pacientit, promovimin dhe ruajtien e shëndetit si dhe parandalimin e sëmundjeve;</p>






	<p>2) Formimin e specialistëve me njohuri të nevojshme shkencore, vlera etike dhe morale në aplikimin e profesionit të Fizioterapistit;</p> <p>3) Përgatitjen e profesionistëve në fizioterapi, me njohuri e kompetenca të nevojshme fizioterapeutike profesionale teorike dhe praktike, të aftë të punojnë në sektorin e rehabilitimit, në përputhje me normat e paracaktuara nga Komuniteti Europian;</p> <p>4) Formimin e profesionistëve të aftë të njohin fenomenet thelbësore biologjike, hereditare, dhe fizopatologjike si dhe ndërthurjen e psikologjisë së individit dhe realitetit socio Ambiental;</p> <p>5) Aftësimin e studentëve për t'u përfshirë në aktivitete konkrete mjekësore dhe për tu angazhuar në funksione të ndryshme në sektorin publik apo privat.</p> <p>Programi i studimit ka po ashtu të përcaktuara qartë dhe strategjinë afatshkurtër, afatmesëm he afatgjatë që duhet të ndjekë për të arritur objektivat e sipërpërmendura.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>24. Program i permbledhur.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Ky program studimi ka në total 180 kredite të cilat studentët mund ti fitojnë brenda tre (3) viteve akademike. Në programin e studimit Bachelor në Fizioterapi, parashikohen lëndët dhe modulet si dhe kreditet për secilën lëndë/modul. Format e studimit parashikohen në nenin 16 të Rregullores së programit të studimit. Në përgjithësi, sipas planit mësimor, parashikohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 32.5 kredite për lëndët bazë (18%);</li> <li>- 92 kredite për lëndët karakterizuese (51%);</li> <li>- 25 kredite për lëndët ndërdisiplinore (14%);</li> <li>- 23.5 kredite për lëndët plotësuese (13%);</li> <li>- 7 kredite për detyrimet përmbyllëse (4%);</li> </ul> <p>Plani mësimor përcakton qartë veprimtaritë formuese. Një student për secalin vit akademik mund të përfitoj deri në 60 ECTS.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabelat 11-12);</i></p>




	<i>Program i permbledhur.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Sipas nenit 17 të Rregullores së programit të studimit, praktika profesionale organizohet dhe monitorohet nga departamenti në kuadër të marrëveshjeve me Institucionet e shërbimit shëndetësor. Praktikë profesionale parashikohet në të tre vitet e studimit. Në total parashikohen 32.5 kredite për Formim Profesional (5 kredite Formim Profesional 1, 11 kredite Formim Profesional 2 dhe 16.5 kredite Formim Profesional 3. Për detyrimet përmbyllëse parashikohen 7 kredite.</p> <p>Rritja e krediteve të praktikës profesionale u raportua si një praktikë e mirë, gjë që ka ndihmuar dhe studentët në punësimin e tyre edhe/ose në njohjen e diplomës jashtë vendit. Institucioni ka hartuar dhe Rregullore për zhvillimin e praktikave mësimore.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>Rregullore e praktikave;</i></p> <p><i>Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabelat 14-15);</i></p> <p><i>24. Program i permbledhur.</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	<p>Jo e aplikueshme pasi ky nuk është një Institucion i Arsimit të Lartë me status të veçantë.</p>
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	<p>Në takimin e zhvilluar me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë ata konfirmuan se ky program studimi është i ngjashëm me programe studimi të Fizioterapisë në Shqipëri si dhe jashtë Shqipërisë. Ata raportuan se janë bazuar në programe të ngjashme për hartimin dhe përditësimin e tij. Paralelisht, raportuan se studentët për shkak të ngjashmërisë e kanë të lehtë njohjen e diploës së tyre në vende të huaja. Institucioni raportoj se ka përcjellë në Ministri të gjitha programet e studimit me qëllim kodifikimin e tyre dhe</p>

	<p>arritjen e ngjashmërisë në një nivel të paktën 70% ose edhe më të lartë.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me përfaqësues të Komisionit të Përhershëm në fushën e kurrikulave dhe standardeve.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në urdhërin e MAS për kodifikimin e programit të studimit, UAL ka përcjellë kodifikimin respektiv për këtë program studimi. Për arsye të menaxhimit të brendshëm, UAL ka përcaktuar kod për secalin program si dhe për lëndët e tij.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>7. Manual FxEducation;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me sekretarinë mësimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Ky nuk është një program i përbashkët por ofrohet vetëm nga UAL.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Ky është një program studimi i ciklit të parë (niveli 6 i kualifikimeve sipas përcaktimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve) me total 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike. Veprimtarite formuese, që karakterizojnë një program studimi, janë leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, praktikat profesionale, projektet e kursit. Format kryesore të kontrollit të dijeve janë kolokiumet, provimet e sesioneve, temat e diplomimit dhe provimi i diplomimit. Sipas planit mësimor, parashikohen 32.5 kredite për lëndët bazë (18%), 92 kredite për lëndët karakterizuese (51%), 25 kredite për lëndët ndërdisiplinore (14%), 23.5 kredite për lëndët plotësuese (13%) dhe 7 kredite për detyrimet përmbyllëse (4%). Në total parashikohen 32.5 kredite për Formim Profesional (5 kredite Formim Profesional 1, 11 kredite</i></p>




	<i>Formim Profesional 2 dhe 16.5 kredite Formim Profesional 3. Për detyrimet përmblylëse parashikohen 7 kredite.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve					
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Universiteti Aldent ka në përbërjen e vet tre (3) Njësi Kryesore. Secila nga Njësitë Kryesore ka tre Njësi Bazë. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë që ofron këtë program studimi përmbush të gjitha detyrimet ligjore.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike si Njësia kryesore që ofron këtë program studimi ka në total për vitin akademik 2023-2024, 100 staf akademik nga të cilët <b>49 personel akademik efektiv (PAE) nga ku:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 6 kanë titullin “Profesor i Asociuar”;</li> <li>- 14 kanë gradën Dr./PhD;</li> <li>- 29 Asistent Lektorë me Msc;</li> </ul> <p><b>dhe 51 staf akademik me kontratë (PAK) nga ku:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 ka titullin “Profesor ”;</li> <li>- 3 kanë titullin “Profesor i Asociuar”;</li> <li>- 16 kanë gradën Dr./PhD;</li> <li>- 31 Asistent Lektorë me Msc;</li> </ul> <p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:</p>					
	<b>2021-2022</b>		<b>2022-2023</b>		<b>2023-2024</b>	
<b>Tituj/ grada</b>	<b>PAE</b>	<b>PAK</b>	<b>PAE</b>	<b>PAK</b>	<b>PAE</b>	<b>PAK</b>
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	1
Prof. Asoc.	2	2	3	1	4	1
Dr./PhD.	3	7	5	8	5	7
SPA	-	1	-	4	-	3

	Msc	7	8	10	7	13	8
	<b>Totali</b>	<b>12</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>20</b>	<b>22</b>	<b>20</b>
	<p><b>Evidenca:</b></p> <p>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabelat 2-4)</p>						
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Me qëllim mbikqyrjen e praktikave profesionale UAL ka staf akademik me kontratë të cilët në rastet më të shumta janë personel shëndetësor i spitaleve ose klinikave në të cilat studentët kryejnë praktikat. Kjo u konfirmua dhe në takimet e zhvilluara me autoritetet drejtuese, stafin akademik dhe studentët. Ata raportuan se kjo u jep mundësinë studentëve të përfitojnë sa më shumë njohuri dhe aftësi duke u mbikqyrur nga personel i cili ka kontakt të rregullt me pacientë. GJVJ e shikon këtë si një pikë të fortë të institucionit. Njësia Kryesore ka 1 staf ndihmës akademik, për sa i përket zhvillimit të orëve të praktikave bëhen nga asistent lektorët e fizioterapisë, profesionistë të fushës, që koordinojnë studentët gjatë praktikave.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabelat 2-4);</p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Për programin e studimit UAL ka të përcaktuar koordinatorin e programit të studimit. Detyrat e tij përcaktohen qartë në Rregulloren e Njesisë Kryesore, neni 11, pika 2. Kjo u konfirmua edhe në takimin e zhvilluar me autoritetet drejtuese të institucionit. Stafi akademik në takimin e zhvilluar raportoi për rolin e koordinatorit i cili ndihmon në implementimin e programit të studimit ndërsa studentët konfirmuan rolin e tij.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>3.2. Rregullore e FSHMT;</p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p>						





	<i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. Njësia kryesore ka caktuar koordinatoren e programit si edhe stuktura ndihmës akademike/administrative që angazhohen në procesin e realizimit të praktikave mësimore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ofron në total katër (4) programe studimi (2 në ciklin e parë dhe 2 në ciklin e dytë). Në vizitën e zhvilluar në Institucion u raportua se pranë Njesisë Bazë disponohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm përfshirë këtu planin mësimor, syllabuset, tezat e provimeve etj. Kjo u konfirmua nda autoritetet drejtuese si dhe nga stafi akademik. Kopje fizike e literaturës nuk ishte e disponueshme pranë Njesisë Bazë por vetëm në bibliotekën e institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Vizita në bibliotekën e UAL.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të	<p>Programi i studimit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm. Ky program studimi ka 180 ECTS të ndara në tre vite (60 kredite në vit – 30 kredite për semestër). Informacion mbi ngarkesën mësimore, modulet, orët në auditor dhe jashtë tij janë të detajuara (Tabelat 11-14). Plani mësimor për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi” është i ndarë në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimet përmbledhëse. Sipas planit mësimor, parashikohen:</p>




lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.

- 32.5 kredite për lëndët bazë (18%);
- 92 kredite për lëndët karakterizuese (51%);
- 25 kredite për lëndët ndërdisiplinore (14%);
- 23.5 kredite për lëndët plotësuese (13%);
- 7 kredite për detyrimet përmblylëse (4%);

Sipas planit mësimor, në total parashikohen 970 orë leksione, 288 orë seminare, 18 orë ushtrime, 130 orë laboratore, 510 orë praktikë profesionale, 14 orë projekte, dhe 84 orë provimi i formimit. Në total parashikohen 2014 orë në auditor dhe 2486 jashtë auditorit (4500 orë në total).

*Plani mësimor nuk përfshihet në rregulloren e programit të studimit ndërsa orët brenda dhe jashtë auditorit për çdo vit akademik prezantohen në dokumentacionin e dorëzuar (sipas tabelës 27).*

Neni 7 dhe 8 i Rregullores së programit të studimeve përcaktojnë kreditet e këtij programi dhe strukturën e studimeve. Neni 2 i Rregullores së Njesisë Kryesore përcakton se programet dhe planet mësimore përcaktohen dhe përditësohen nga Njësia Bazë para fillimit të vitit akademik dhe miratohen nga Senati Akademik.


<b>Bachelor në Fizioterapi</b>	<b>Viti I</b>	<b>Viti II</b>	<b>Viti III</b>	<b>Në total</b>
Në auditor	646	645	723	2014
Leksione	360	355	255	970
Seminare	112	104	72	288
Ushtrime	6	6	6	18
Laboratore	90	20	20	130
Projekte	3	5	6	14
Praktika	75	155	280	510
Punë e pavarur e studentit	854	855	777	2486
<b>Gjithsej</b>	<b>1500</b>	<b>1500</b>	<b>1500</b>	<b>4500</b>

**Evidenca:**

*3.2. Rregullore e FSHMT;*

*16. Rregullore e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi;*

	<p>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</p> <p>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabelat 11-14, 27);</p> <p>24. Program i permbledhur.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Neni 37 i Rregullores së Njësisë Kryesore përcakton kriteret për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit. Neni 50 i Rregullores së UAL përcakton kushtet për pranimin në ciklin e parë të studimeve. Nenet 3-5 të Rregullores së programit të studimit përcaktojnë qartë kushtet e pranimit, regjistrimit dhe shkëputjes ose rifillimit të studimeve. Transferimi i studimeve përcaktohet me detaje në nenin 54 të Rregullores së IAL-së, në nenin 6 të Rregullores së programit si dhe në Rregulloren specifike që institucioni ka përgatitur. Neni 42 b i Rregullores së UAL përcakton transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Procedura e transferimit të studimeve përcaktohet dhe në evidencën 6.2. Njohja dhe ekuivalentimi i studimeve përcaktohen dhe në nenet 68-69 të Rregullores së UAL-së.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>3.1. Rregullore e Universitetit;</p> <p>3.2. Rregullore e FSHMT;</p> <p>6.2. Procedura e transferimit të krediteve;</p> <p>16. Rregullore e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi;</p> <p>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</p> <p>24. Program i permbledhur.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për programet lëndore për secilën lëndë. Syllabuset përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi. Informacion i përgjithshëm mbi lëndën (titullari, pedagogu, kreditet/ngarkesa, viti/semestri etj), objektivat e saj, temat që trajtohen, format e kontrollit, literaturën bazë dhe të rekomanduar etj. Institucioni ka hartuar dhe Rregullore për zhvillimin e praktikave mësimore.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</p> <p>18. Rregullore e praktikave;</p> <p>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabela 26);</p> <p>24. Program i permbledhur;</p>






	<p>27.1. SYLLABUS V1; 27.2. SYLLABUS V2; 27.3. SYLLABUS V3.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Autoritetet drejtuese si dhe stafi akademik raportuan se përditësojnë rregullisht syllabuset e tyre. Kjo procedurë zhvillohet në fillim të vitit akademik. Stafi akademik raportoi se ky process ndodh rregullisht ku ata përditësojnë literaturën. Ky process ndodh nën kujdesin e koordinatorit të programit të studimit raportoi stafi akademik. Fillimisht pedagogu i lëndës përcjell kërkesën për miratim të ndryshimeve respektive dhe më pas ato miratohen nga drejtuesi i departamentit. Literatura rinovohet ndërsa institucioni përgatit dhe cikël leksionesh (në varësi të pedagogëve). Një procedurë e tillë u dorëzua nga UAL.</p> <p><i>Bazuar në procedurën e dorëzuar nga UAL, GVJ vëren se nuk përfshihet titullari i lëndës. Paralelisht, GVJ vëren se ka një mospërputhje me atë që raportohet në RVJ dhe në dokumentin shitesë të dorëzuar nga institucioni. <u>GVJ sugjeron që procedura duhet të standardizohet dhe të përfshihet në rregulloren e Njesisë Bazë.</u></i></p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>26. Literatura e aprovuar e programit të studimit; 27.1. SYLLABUS V1; 27.2. SYLLABUS V2; 27.3. SYLLABUS V3;</p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik.</i></p> <p><i>Perditesim syllabusi;</i></p> <p><i>Perditesim literature.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Pranë Njesisë Bazë disponohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm përfshirë këtu planin mësimor, syllabuset, tezat e provimeve etj. Sipas planit mësimor, në total parashikohen 970 orë leksione, 288 orë seminare, 18 orë ushtrime, 130 orë laboratore, 510 orë praktikë profesionale, 14 orë projekte, dhe 84 orë provimi i formimit. Në total parashikohen 2014 orë në auditor dhe 2486 jashtë auditorit (4500 orë në total). Nenet 3-5 të Rregullores së programit të studimit përcaktojnë qartë kushtet e pranimit, regjistrimit dhe shkëputjes ose rifillimit të studimeve. Autoritetet drejtuese si dhe stafi akademik</i></p>





	<i>raportuan se përditësojnë rregullisht syllabuset e tyre. <u>GVJ sugjeron</u> që procedura duhet të standardizohet dhe të përfshihet në rregulloren e Njesisë Bazë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi II.4


**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit "Bachelor" ne "Fizioterapi" ka përcaktuar si mision të tij: a) Të përgatisë studentë me njohuritë bazë të rehabilitimit b) Të përgatisë studentë me njohuritë mbi ekzaminimin klinik, diagnostifikimin dhe ngritjen e protokolleve fizioterapeutike afatshkurtër dhe afatgjatë c) Të përgatisë studentë që zotërojnë sa më shumë metoda dhe teknologji moderne të fizioterapisë d) Të përgatisë studentë të cilët kanë njohuri të plota mbi diagnoza neurologjike, ortopedike, pediatrike, reumatologjike, interne etj. në grupmosha të ndryshme e) Të përgatisë studentët të trajtojnë pacientët më problematika posturale f) Të përgatisë studentë të cilët do dijnë të ndërveprojnë në një grup multidisiplinar g) Të përgatisë studentët të aftë për të konkuruar në tregun vendas dhe të huaj h) Të kontribuojë në zhvillimin, emancipimin dhe rritjen e standardeve të shkencës së fizioterapisë duke përgatitur të rinjtë për të qenë pjesë e denjë e saj. Plani mësimor është i ngjashëm me programe studimi në të njëjtën fushë brenda dhe jashtë Shqipërisë. Në planin mësimor përfshihen leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktikë profesionale dhe detyra/projekte. Përmes këtyre studentët kanë mundësinë të rrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre. Njohuritë dhe aftësitë që përfitohen nga ky program studimi prezantohen në syllabuset e lëndëve. Në takimin e zhvilluar me autoritetet drejtuese, u raportua se studentët kanë mundësinë të vazhdojnë studimet e tyre në bazë të këtij programi. Paralelisht, në takimin me studentët, pjesa më e madhe raportoi se do të vazhdojnë studimet e tyre në këtë fushë tek i njëjti Institucion, ndërsa një pjesë e vogël raportoi se mund të kërkoj punë ose do iki jashtë vendit.


	<p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabela 15, 27);</i></p> <p><i>24. Program i permbledhur;</i></p> <p><i>27.1. SYLLABUS V1;</i></p> <p><i>27.2. SYLLABUS V2;</i></p> <p><i>27.3. SYLLABUS V3;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b></p> <p>Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Programi i studimit ka në total 180 kredite të cilat studentët mund ti fitojnë brenda 3 viteve akademike. Secili modul/lëndë përfshin sipas planit mësimor kreditet e përcaktuara si dhe elementët e vet. Plani mësimor për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi” është i ndarë në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimet përmbledhëse. Sipas planit mësimor, parashikohen 32.5 kredite për lëndët bazë (18%), 92 kredite për lëndët karakterizuese (51%), 25 kredite për lëndët ndërdisiplinore (14%), 23.5 kredite për lëndët plotësuese (13%) dhe 7 kredite për detyrimet përmblylëse (4%). Sipas planit mësimor, në total parashikohen 970 orë leksione, 288 orë seminare, 18 orë ushtrime, 130 orë laboratore, 510 orë praktikë profesionale, 14 orë projekte, dhe 84 orë provimi i formimit. Në total parashikohen 2014 orë në auditor dhe 2486 jashtë auditorit (4500 orë në total).</p> <p><i>Plani mësimor nuk përfshihet në rregulloren e programit të studimit, ndërsa orët brenda dhe jashtë auditorit për çdo vit akademik prezantohen në dokumentacionin e dorëzuar (sipas tabelës 27). GVJ vlerëson se përmes moduleve/lëndëve arrihen objektivat e përcaktuara. Kjo u konfirmua dhe në takimet e zhvilluara me grupet e ndryshme përfshirë këtu autoritetet drejtuese, staf akademik dhe studentët.</i></p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabela 15, 27);</i></p> <p><i>24. Program i permbledhur;</i></p>




	<p>27.1. SYLLABUS V1;  27.2. SYLLABUS V2;  27.3. SYLLABUS V3;  <i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i>  <i>Takim me stafin akademik;</i>  <i>Takim me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi i studimit përfshin orë brenda dhe jashtë auditorit. Në total ky program ofrohet në tre vite akademike dhe kërkon angazhimin për 4500 orë,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2014 brenda në auditor;</li> <li>- 2486 jashtë auditorit;</li> </ul> <p>Programi përfshin teori dhe praktikë. Programi i studimit është i ngjashëm me programe të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë raportuan Drejtueset e Njesisë Kryesore dhe Bazë në takimin e zhvilluar. Sipas planit mësimor, në total parashikohen 970 orë leksione, 288 orë seminare, 18 orë ushtrime, 130 orë laboratore, 510 orë praktikë profesionale, 14 orë projekte, dhe 84 orë provimi i formimit. Format e mësimdhënies përcaktohen dhe në Rregulloren e Institucionit (neni 34).</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.1. Rregullore e Universitetit;</i>  <i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i>  <i>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabela 15, 27);</i>  <i>24. Program i permbledhur;</i>  <i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Disiplinat mësimore të programit të studimit Bachelor në Fizioterapi, janë të organizuara në pesë kategori, nga A tek E. Kjo parashikohet në nenin 16 të Rregullores së Njesisë Bazë. Plani mësimor për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi” është i ndarë në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimet përmbledhëse. Sipas planit mësimor, parashikohen 32.5 kredite për lëndët bazë (18%), 92 kredite për lëndët karakterizuese (51%), 25 kredite për lëndët ndërdisiplinore (14%), 23.5 kredite për lëndët plotësuese (13%) dhe 7 kredite për detyrimet përmblylëse (4%). Raporti teori/praktik për programin e studimit Bachelor në Fizioterapi mundëson arritjen e objektivave formuese.</p>

	<p>Paralelisht, parashikohet dhe në aktet e brendshme të UAL mundësia për transferim të studimeve, mobilitet ose punësim. Në takimin me studentët ata raportuan se janë të informuar për mundësinë e mobilitetit por asnjë nga ata nuk kishte zhvilluar një të tillë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që UAL të rrisi përpjekjet për të bindur studentët për të kryer mobilitete në IAL jashtë Shqipërisë. Në vizitën në sekretarinë mësimore dhe në bazë të dokumentacionit, nuk u evidentua ndonjë student të kishte zhvilluar transferim të studimeve.</i></p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.1. Rregullore e Universitetit;</i></p> <p><i>3.2. Rregullore e FSHMT;</i></p> <p><i>16. Rregullore e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi;</i></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabela 14-15);</i></p> <p><i>24. Program i permbledhur;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Autoritetet drejtuese si dhe stafi akademik raportuan se përditësojnë rregullisht syllabuset e tyre. Kjo procedurë zhvillohet në fillim të vitit akademik. Stafi akademik raportoi se ky proces ndodh rregullisht ku ata përditësojnë literaturën. Ky proces ndodh nën kujdesin e koordinatorit të programit të studimit raportoi stafi akademik. Fillimisht pedagogu i lëndës përcjell kërkesën për miratim të ndryshimeve respektive dhe më pas ato miratohen nga drejtuesi i departamentit. Bazuar në procedurën e dorëzuar nga UAL, <i>GVJ vëren se nuk përfshihet titullari i lëndës. Paralelisht, GVJ vëren se ka një mospërputhje me atë që raportohet në RVJ dhe në dokumentin shtesë të dorëzuar nga institucioni. GVJ sugjeron që procedura duhet të standardizohet dhe të përfshihet në rregulloren e Njesisë Bazë.</i></p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>26. Literatura e aprovuar e programit të studimit;</i></p> <p><i>27.1. SYLLABUS V1;</i></p> <p><i>27.2. SYLLABUS V2;</i></p>




	<p>27.3. SYLLABUS V3;</p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik.</i></p> <p><i>Perditesim syllabusi;</i></p> <p><i>Perditesim literature.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit u mundëson studentëve përfitimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të synuara. Objektivat e programit të studimit janë të prezantuara në Rregulloren e programit si dhe në syllabuset respektive. Kjo gjë u raportua dhe në takimin e zhvilluar me Drejtueset e Njesisë Kryesore dhe Bazë. Përfshirja e teorisë dhe praktikës rrit kompetencat e studentëve për përdorimin e tyre gjatë punësimit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>24. Program i permbledhur;</i></p> <p><i>27.1. SYLLABUS V1;</i></p> <p><i>27.2. SYLLABUS V2;</i></p> <p><i>27.3. SYLLABUS V3;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi u jep mundësinë studentëve në përfundim të studimeve të vazhdojnë një program të ciklit të dytë ose të punësohen. Një pjesë e studentëve që morrën pjesë në takim raportuan se do të vazhdojnë studimet e tyre në programin Master në Fizioterapi pranë UAL.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit ka në total 180 kredite të cilat studentët mund ti fitojnë brenda 3 viteve akademik. Në total ky program ofrohet në tre vite akademike dhe kërkon angazhimin për 4500 orë (2014 brenda në auditor dhe 2486 jashtë). Secili modul/lëndë përfshin sipas planit mësimor kreditet e përcaktuara si dhe elementët e vet. Plani mësimor nuk përfshihet në rregulloren e programit të studimit ndërsa orët</i></p>




	<p><i>brenda dhe jashtë auditorit për çdo vit akademik prezantohen në dokumentacionin e dorëzuar. GVJ vlereson se përmes moduleve/lëndëve arrihen objektivat e përcaktuara. Disiplinat mësimore të programit të studimit Bachelor në Fizioterapi, janë të organizuara në pesë kategori, nga A tek E.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që UAL të rrisi përpjekjet për të bindur studentët për të kryer mobilitete në IAL jashtë Shqipërisë.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që procedura e përditësimit të syllabuseve dhe programit mësimore të standardizohet dhe të përfshihet në rregulloren e Njesisë Bazë. Programi i studimit u mundëson studentëve përfitimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të synuara.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>UAL ka një numër të konsiderueshëm marrveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë si dhe me klinika private pranë të cilave studentët mund të zhvillojnë praktikën profesionale. Në takimin e zhvilluar me autoritetet drejtuese u raportua se përfshihen student alumni edhe/ose ekspertë të jashtëm në përmirësimin e programit të studimit. Në bashkëpunim me këta është përmirësuar programi i studimit duke rritur orët laboratorike. Ndryshimet bëhen dhe duke u bazuar në eksperiencën e stafit akademik. Ndryshimet e propozuara miratohen në departament. <i>GVJ nuk arriti të evidentonte përditësim të programit të studimit ku të përfshihen student alumni dhe bashkëpunorë nga institucione partnere. GVJ rekomandon që përditësimet që përfshin këta aktor të evidentohen dhe të dokumentohen nga Njësia Bazë. UAL ka ekspert të jashtëm pranë NJSBC të cilët ndihmojnë në përmirësimin e programeve të studimit. GVJ e konsideron një praktikë të mirë këtë.</i></p> <p><b>Evidenca:</b></p>




	<i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	<p>Studentët e UAL janë të përfshirë në strukturat e ndryshme të institucionit sipas kuadrit ligjor. Studentët janë anëtarë të Senatit Akademik, NJSBC, komisioneve të ndryshme si dhe pjesë e hartimit të raporteve të vetëvlerësimit për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit. Studentët raportuan se vlerësojnë rregullisht stafin akademik dhe lëndët e kryera si dhe raportojnë problematikat apo gjërat që ata kanë nevoj të përmirësojnë.</p> <p><i>GVJ nuk mundi të evidentonte përfshirje të studentëve alumni si dhe të studentëve aktual në përmirësimin e programit të studimit. Përfshirja e ulët e studentëve në përmirësimin e kurrikulës u raportua dhe nga përfaqësuesit e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë;</i></p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>1. Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me studentët;</i></p> <p><i>Takim me përfaqësues të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<p>Njësia Bazë mban kontakte me Urdhërin e Infermierit me qëllim ndryshimet e nevojshme në programin e studimit bazuar dhe në nevojat e tregut të punës. Po ashtu mban dhe kontakte me klinika fizioterapie. Zakonisht kontaktet janë informale dhe <i>GVJ nuk arriti të evidentonte bashkëpunime të tilla me qëllim përmirësimin e programit të studimit.</i></p> <p>Përfaqësuesit e NJSBC-së raportuan se institucioni mban kontakte me Urdhërin e Infermierit duke organizuar trajime të ndryshme si dhe me Shoqata Fizioterapiste. Trajnimet e zhvilluara, përfshihen në lëndët e rrahabilitimit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me përfaqësues të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.</i></p>



<b>Konkluzione</b>	<i>UAL ka një numër të konsiderueshëm marrveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë si dhe me klinika private pranë të cilave studentët mund të zhvillojnë praktikën profesionale. GVJ nuk arriti të evidentonte përditësim të programit të studimit ku të përfshihen student alumni apo/edhe ekspertë të jashtëm dhe bashkëpunorë nga institucione partnere ose shoqata të ndryshme. GVJ rekomandon që përditësimet që përfshin këta aktor të evidentohen dhe të dokumentohen nga Njësia Bazë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>					
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënësve, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>					
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>				
<b>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</b>	Sipas nenit 34 të Rregullores së Institucionit dhe nenit 21 të Rregullores së Njesisë Kryesore format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive janë leksionet, seminarët, ushtrimet, orët laboratorike, praktikat profesionale dhe detyrat e kursit. Neni 8 i Rregullores së programit të studimit përcakton dhe frekuentimin që duhet të bëjnë studentët në secilën nga format e përmendura më lart. UAL po ashtu organizon orë të hapura me ekspert të fushës. Kjo u konfirmua dhe në takimet e zhvilluara në institucion.				
	<b>Bachelor në Fizioterapi</b>	<b>Viti I</b>	<b>Viti II</b>	<b>Viti III</b>	<b>Në total</b>
	Në auditor	646	645	723	2014




Leksione	360	355	255	970
Seminare	112	104	72	288
Ushtrime	6	6	6	18
Laboratore	90	20	20	130
Projekte	3	5	6	14
Praktika	75	155	280	510
Punë e pavarur e studentit	854	855	777	2486
<b>Gjithësej</b>	<b>1500</b>	<b>1500</b>	<b>1500</b>	<b>4500</b>

**Evidenca:**

*3.1. Rregullore e Universitetit;*

*3.2. Rregullore e FSHMT;*

*16. Rregullore e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi;*

*17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;*

*Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;*

*Takim me studentët.*

**Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.

Personeli akademik i UAL zhvillon mësimdhënie, kërkim shkencor ndërsa ofron po ashtu dhe kontribut institucional dhe profesional. Personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies përfshirë këtu leksionet, seminarët, ushtrimet, orët laboratorike, praktikat profesionale dhe detyrat e kursit. Përdorimi i secilës forëm si dhe masa e saj është e detajuar në syllabuset e lëndëve/moduleve. Prkatikat profesionale zhvillohen në institucione shëndetësore dhe në klinika private. Kjo i ndihmon studentët të rrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre në mënaxhimin e pacientëve. Në takimin me autoritetet drejtuese u raportua se stafi akademik ka mundësi të zhvilloj module deri në 2,5 kredite duke përdorur Moodle. Ata raportuan se kjo përdoret vetëm për metodën e testimin.


*GVJ inkurajon përdorimin e metodave alternative të mësimdhënies duke respektuar kuadrin ligjor dhe aktet e brendshme të institucionit.*

**Evidenca:**


*3.1. Rregullore e Universitetit;*

*3.2. Rregullore e FSHMT;*

	<p>16. Rregullore e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi;</p> <p>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</p> <p>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabela 21);</p> <p>27.1. SYLLABUS V1;</p> <p>27.2. SYLLABUS V2;</p> <p>27.3. SYLLABUS V3;</p> <p>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</p> <p>Takim me stafin akademik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni mbështet rregullisht përmirësimin e kompetencave didaktike të stafit akademik. Bazuar në marrëveshjet që IAL ka me institucione partnere, stafi akademik mund të zhvilloj mobilitete për mësimdhënie dhe trajnim. Po ashtu, UAL, organizon orë të hapura me personalitete të ndryshme. Organizimi i trajnimeve u raportua nga autoritetet drejtuese dhe u konfirmua dhe nga stafi akademik. Një nga praktikatat që autoritetet raportuan ishte se mundohen mos të marrin staf akademik pa eksperiencë mësimore. Paralelisht, u raportua se stafi i UAL është me një eksperiencë të madhe pune në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor. Po ashtu u raportua dhe një trajnim 2-javor i stafit në kërkim shkencor dhe mësimdhënie. Stafi akademik raportoi se është mbështetur financiarisht për pjesëmarrje në aktivitete shkencore për përmirësim profesional. GVJ e konsideron këtë si një praktik të mirë të cilën UAL duhet ta vazhdoj duke rritur numërin e përfituesve. Përfaqsesit e Komisioneve të përhershme raportuan se fondet jepen në bazë të kërkesave. Ata raportuan se organizimi i konferencave mbështetet financiarisht por nuk jepet pagesë për stafin akademik. U raportua dhe rasti i disa pedagogëve italianë të cilët u financuat totalisht nga UAL. Rregullisht institucioni përditëson dosjen e personelit akademik me arritjet e tyre më të fundit. Kjo u konfirmua dhe nga takimi i zhvilluar me përfaqsesin e Burimeve Njerëzore. Në momentin që një pedagog i ri punësohet, UAL e ndihmon atë për përshtatjen e tij më të shpejtë në Institucion me ndihmën e tutorit. Kjo u konfirmua nga stafi akademik dhe nga autoritetet drejtuese.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>10. Të dhëna mbi mobilitetet;</p> <p>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabela 21);</p>




	<p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me përfaqësues të Komisionit të Përhershëm në fushën e kurrikulave dhe standardeve;</i></p> <p><i>Takim me përfaqësues të Komisionit të Përhershëm në fushën e kërkimit shkencor;</i></p> <p><i>Takim me përfaqësues të Burimeve Njerëzore.</i></p> <p><i>Aldent University and Acibadem University MOU;</i></p> <p><i>Ankara University;</i></p> <p><i>Marreveshje ALBMEDTECH;</i></p> <p><i>Marreveshje me QSUT;</i></p> <p><i>MARREVEESHJE ME TRAUMEN;</i></p> <p><i>MARREVEESHJE UAL-MJEKESI;</i></p> <p><i>Marrveshja me Istynie University;</i></p> <p><i>Email screen-shot.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>UAL ka një staf me eksperienc të gjatë në fushën e mësimdhënies dhe atë të kërkimit shkencor. Ata janë kompetent në fushën e tyre ndërsa përmes mobiliteteve dhe trajnimeve mundohen të përmirësojnë rregullisht aftësitë e tyre. Stafi akademik zhvillon lëndët/modulet në të cilat është i specializuar ndërsa praktikën klinike e mbikëqyrin persona që kanë punuar/punojnë në spitale ose klinika. Mësimdhënia zhvillohet me në qendër studentin. Stafi akademik raportoi se përdor metoda të ndryshme përfshirë këtu bashkëbisedimet, punën individuale, simulimet (duke përdorur një krevat dhe një nga studentët bën pacientin dhe tjetri të sëmurin), case-study, foto-video të cilat studentët komentojnë etj. Këto metoda u konfirmuan dhe nga studentët në takimin e zhvilluar. Personeli akademik u vë në dispozicion studentëve materiale të ndryshme për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre përmes sistemit elektronik të UAL-së.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>10. Të dhëna mbi mobilitetet;</i></p> <p><i>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabela 21);</i></p> <p><i>28.1. Cv.Bsc.Fizio;</i></p> <p><i>28.2. Cv_PAK_Fizio;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p>




	<p><i>Takim me studentët.</i></p> <p><i>Aldent University and Acibadem University MOU;</i></p> <p><i>Ankara University;</i></p> <p><i>Marreveshje ALBMEDTECH;</i></p> <p><i>Marreveshje me QSUT;</i></p> <p><i>MARREVESHJE ME TRAUMEN;</i></p> <p><i>MARREVESHJE UAL-MJEKESI;</i></p> <p><i>Marrveshja me Istynie University.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Studentët marrin pjesë në përmirësimin e programit të studimit. Rregullisht ata vlerësojnë stafin akademik përmes një pyetësori on-line të standardizuar i cili ka si qëllim përmirësimin e mësimdhënies. Studentët raportuan se vlerësojnë stafin akademik dhe kanë parë përpjekje për përmirësimin e gjërave të cilat nuk janë mirë. Stafi akademik konfirmoi se vlerësohet mësimdhënien nga studentët dhe rezultatet u bëhen atyre të ditura nga koordinatori i programit. Stafi akademik theksoi po ashtu se në bazë të performancës në pyetësoren e studentëve është zhvilluar dhe promovimi i tyre si dhe/ose janë zhvilluar dhe aktivitete trajnuese. Përfaqësuesit e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë raportuan disa shëmbuj të përmirësimit të mësimdhënies bazuar në komentet e studentëve përfshirë këtu rritjen e orëve të praktikës dhe uljen e orëve teorike. Studentët po ashtu ndihmojnë në promovimin e pyetësorit me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në plotësimin e tij.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>11. Pyetësoret e studenteve-model;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët;</i></p> <p><i>Takim me përfaqësues të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me</p>	<p>UAL ka në organikën e vet Njësine e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë e cila në bashkëpunim me Komisionet e përhershme si dhe Njësitë e tjera mundohen të përmirësojnë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Përfaqësuesit e NJSBC konfirmuan se organizojnë trajnime të ndryshme me qëllim zhvillimin institucional dhe profesional. Trajnimet fokusohen në metodologjinë e mësimdhënies, përdorimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie etj. U raportua se qëllimi i tyre është organizimi i të paktën një aktiviteti trajnues në muaj.</p>




<p>njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>1. Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>3.3. Rregullore e NJSBC;</i></p> <p><i>Takim me përfaqësues të Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë;</i></p> <p><i>Takim me përfaqësues të Komisionit të Përhershëm në fushën e kurrikulave dhe standardeve.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive janë leksionet, seminarët, ushtrimet, orët laboratorike, praktikat profesionale dhe detyrat e kursit. Personeli akademik i UAL zhvillon mësimdhënie, kërkim shkencor ndërsa ofron po ashtu dhe kontribut institucional dhe profesional. GVJ inkurajon përdorimin e metodave alternative të mësimdhënies duke respektuar kuadrin ligjor dhe aktet e brendshme të institucionit. Stafi akademik raportoi se është mbështetur financiarisht për pjesëmarrje në aktivitete shkencore për përmirësim profesional. GVJ e konsideron këtë si një praktik të mirë të cilën UAL duhet ta vazhdojë duke rritur numërin e përfituesve. Mësimdhënia zhvillohet me në qendër studentin. Stafi akademik konfirmoi se vlerësohet mësimdhënia nga studentët dhe rezultatet u bëhen atyre të ditura nga koordinatori i programit. UAL ka në organikën e vet Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.2</b></p>	
<p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e</b></p>	<p>Frekuentimi i formave të ndryshme të mësimdhënies është i detyrueshëm në nivele të ndryshme. Neni 39 i Rregullores së</p>




vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.

Institucionit përcakton mënyrën e kontrollit të dijeve. Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde, kur ka shlyer detyrimet vjetore që lidhen atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor. Procesverbali i shlyerjes së këtyre detyrimeve plotësohet nga pedagogu në përfundim të procesit mësimor, para sesionit të provimeve dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore. Emrat e studenteve, që kanë fituar të drejtën për të hyrë në provimin e lëndes, paraqiten në fletën e provimit. Ajo plotësohet me emra dhe mbyllet nga sekretaria mësimore, nënshkruhet nga Dekani përkundrejt nënshkrimit të sekretarisë dhe mban vulën e Universitetit "Aldent". Fleta e provimit i dorëzohet komisionit të provimit ditën e provimit. Me përfundimin e provimit, Kryetari i komisionit e dorëzon atë në sekretari. Në nivel fakulteti brenda një viti akademik planifikohen katër sesione provimesh. Sesionet e provimeve bazë organizohen, si rregull, në çdo fund semestri dhe kanë kohështrirje 2 deri në 4 javë. Studenti/ja ka të drejtë të shlyejë detyrimet sipas sesioneve përkatëse: 1. Dy sesione bazë: Sesioni i shkurtit (semestri i parë). b Sesioni i qershorit (semestri i dytë). 2. Sesioni i moduleve: modulet e vitit akademik pa sezon. 3. Tre sesione të mbartura: Sesioni i shtatorit. Sesioni i dhjetorit. Sesioni i prillit.

Provimet dhe riprovimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik, nga Senati i Universitetit "Aldent" dhe shpallen disa ditë para fillimit të sesionit. Në përcaktimin e datave të provimeve merret paraprakisht edhe mendimi i studentëve. Provimet zhvillohen në orën dhe datën e caktuar. Në rast pamundësie të jashtëzakonshme të zhvillimit të provimit në datën e caktuar, Dekani me urdhër me shkrim e anulon atë dhe cakton një datë të mëvonshme, e cila u bëhet e njohur studentëve. Studentët merren në provimin e kursit minimalisht nga dy pedagogë të fushes: titullari i lëndës dhe asistenti përkatës të cilët kanë zhvilluar lëndën. Nëse lënda nuk ka patur asistent, prgjegjësi i departamentit cakton një asistent të një discipline të përafërt. Nëse titullari i lëndës ose asistenti i tij për arsye madhore nuk mund të marrin pjesë në provim, përgjegjësi i departamentit përmes një vendimi me shkrim cakton punonjësit që do t'i zëvendësojnë. Provimet me shkrim bëhen të sekretuar. Sipas nenit 11 të Rregullores së Departamentit, grafiku i provimeve hartohet nga departamenti në bashkëpunim me koordinatorin e programit dhe publikohet të paktën 2 javë para provimit. Nenet 9-10 të Rregullores së programit të studimit detajojnë mënyrën e vlerësimin të



	<p>studentëve. Detaje mbi kriteret e vlerësimit jepen dhe në syllabuset e secilës lëndë/modul.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>3.1. Rregullore e Universitetit;</p> <p>3.2. Rregullore e FSHMT;</p> <p>3.6. Rregullore provimi;</p> <p>16. Rregullore e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi;</p> <p>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</p> <p>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabela 26);</p> <p>27.1. SYLLABUS V1;</p> <p>27.2. SYLLABUS V2;</p> <p>27.3. SYLLABUS V3.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të çdo lëndë/moduli stafi akademik informon studentët për lëndën/modulin, metodologjinë e mësimdhënies dhe testimit e vlerësimit si dhe u vë atyre në dispozicion syllabusin respektiv. Kjo procedurë u konfirmua dhe nga studentët në takimin e zhvilluar. Stafi akademik u vë në dispozicion syllabusin e lëndës/modulit si dhe matëriale të tjera mbështetëse. Këto matëriale u vihen në dispozicion studentëve përmes sistemit elektronik, grupeve të ndryshme në rrjete sociale (WhatsApp) ose me email.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>Takim me stafin akademik;</p> <p>Takim me studentët.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive zhvillohet duke përdorur metoda të ndryshme dhe realizohet nëpërmjet vlerësimit gjithëvjeter (përkatësisht semestral) të punës në auditor, përgatitjes së detyrave të kursit, rezultateve laboratorike, praktikës profesionale dhe provimit përfundimtar. Autoritetet drejtuese raportuan një system 10/20/10/60 për secilën nga metodat e ndryshme. Këto varen dhe nga modalitetet respektive të lëndës/modulit që specifikohen në syllabus. Përcaktimi i raporteve në mes të vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga çdo pedagog dhe paraqitet në programin e lëndës. Stafi akademik dhe studentët konfirmuan këtë procedurë.</p>






	<p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabela 21);</i></p> <p><i>27.1. SYLLABUS V1;</i></p> <p><i>27.2. SYLLABUS V2;</i></p> <p><i>27.3. SYLLABUS V3;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Studentët marrin pjesë në përmirësimin e programit të studimit. Rregullisht ata vlerësojnë stafin akademik përmes një pyetësori on-line të standardizuar i cili ka si qëllim përmirësimin e mësimdhënies. Studentët raportuan se vlerësojnë stafin akademik dhe kanë parë përpjekje për përmirësimin e gjërave të cilat nuk janë mirë. Stafi akademik konfirmoi se vlerësohet mësimdhënja nga studentët dhe rezultatet u bëhen atyre të ditura nga koordinatori i programit. Stafi akademik theksoi po ashtu se në bazë të performancës në pyetësorin e studentëve është zhvilluar dhe promovim i tyre si dhe/ose janë zhvilluar dhe aktivitete trajnuese. Përfaqësuesit e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë raportuan disa shëmbuj të përmirësimit të mësimdhënies bazuar në komentet e studentëve përfshirë këtu rritjen e orëve të praktikës dhe uljen e orëve teorike. Studentët po ashtu ndihmojnë në promovimin e pyetësorit me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në plotësimin e tij.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>11. Pyetësoret e studenteve-model;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët;</i></p> <p><i>Takim me përfaqësues të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit,</p>	<p>UAL përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies të cilat përfshinë leksionet, seminarat, ushtrimet, orët laboratorike, praktikat profesionale dhe detyrat e kursit. Praktikrat mësimore të cilat zhvillohen në spital ose klinika private nga studentët me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive të tyre si dhe praktikimin e teorive të marra në leksione dhe seminare të zhvilluara në auditor. Një nga studentët raportoi se i pëlqen mënyra e mësimdhënies e kombinuar më praktikën</p>




<p>objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>sepse i bën të mundur implementimin e njohurive të marra. Mësimdhënia zhvillohet me në qendër studentin. Stafit akademik raportoi se përdor metoda të ndryshme përfshirë këtu bashkëbisedimet, punën individuale, simulimet (duke përdorur një krevat dhe një nga studentët bën pacientin dhe tjetri të sëmurin), case-study, foto-video të cilat studentët komentojnë si etj. Këto metoda u konfirmuan dhe nga studentët në takimin e zhvilluar.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabela 18);</i></p> <p><i>27.1. SYLLABUS V1;</i></p> <p><i>27.2. SYLLABUS V2;</i></p> <p><i>27.3. SYLLABUS V3;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Neni 39 i Rregullores së Institucionit përcakton mënyrën e kontrollit të dijeve. Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde, kur ka shlyer detyrimet vjetore që lidhen atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor. Në fillim të çdo lënde/moduli stafi akademik informon studentët për lëndën/modulin, metodologjinë e mësimdhënies dhe testimin e vlerësimit si dhe u vë atyre në dispozicion syllabusin respektiv. Vlerësimi i njohurive zhvillohet duke përdorur metoda të ndryshme dhe realizohet nëpërmjet vlerësimit gjithëvjetor. Studentët marrin pjesë në përmirësimin e programit të studimit. Rregullisht ata vlerësojnë stafin akademik përmes një pyetësi on-line të standardizuar i cili ka si qëllim përmirësimin e mësimdhënies.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi III.3**




**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Neni 39 i Rregullores së Institucionit përcakton mënyrën e kontrollit të dijeve. Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde, kur ka shlyer detyrimet vjetore që lidhen atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor. Kontrolli i dijeve të përvetësuar nga studenti bëhet nëpërmjet testeve, detyrave të kursit, të cilat zhvillohen gjatë semestrit ku zhvillohet lënda ose moduli përkatës dhe nëpërmjet provimeve përfundimtare. Studentëve, nga ana e pedagogëve të lëndës, u bëhet e ditur në fillim të lëndës mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është pjesë e syllabusit të lëndës ose modulit përkatës që iu dorëzohet studentëve. Syllabusi i lëndës konsiderohet si "kontrata" më e rëndësishme midis studentit dhe pedagogut të lëndës, të drejtat dhe detyrimet e së cilës janë të detyrueshme për të dy palët. Studenti, mund të shlyejë një pjesë të lëndës nëpërmjet testeve (kolokiumeve) që zhvillohen gjatë vitit, vetëm në rastet kur kjo është parashikuar në syllabusin e lëndës. Vlerësimi i studentit për pjesen e lëndës së shlyer do të bëhet me pike, të cilat u shtohen pikëve të provimit përfundimtar. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe komulative me pikë. Pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të lëndës u shtohen pikët e provimit përfundimtar duke përcaktuar totalin e pikëve të grumbulluara nga studenti bashkë me notën përkatëse. Vlerësimi i njohurive zhvillohet duke përdorur metoda të ndryshme dhe realizohet nëpërmjet vlerësimit gjithëvjetor (përkatësisht semestral) të punës në auditor, përgatitjes së detyrave të kursit, rezultateve laboratorike, praktikës profesionale dhe provimit përfundimtar. Autoritetet drejtuese raportuan një system 10 (ndjekje e lëndës dhe pjesmarrja) /20 (detyrimet specifike psh. Detyra kursi, orë laboratorike etj. /10 (testimet gjatë vitit) /60 (provimi përfundimtar) për secilën nga metodat e ndryshme. Këto u konfirmuan dhe në takimet e zhvilluara në UAL.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>3.1. Rregullore e Universitetit;</p> <p>3.2. Rregullore e FSHMT;</p> <p>3.6. Rregullore provimi;</p> <p>16. Rregullore e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi;</p>




	<p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>27.1. SYLLABUS V1;</i></p> <p><i>27.2. SYLLABUS V2;</i></p> <p><i>27.3. SYLLABUS V3;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni nuk përdor sisteme kontrolli elektronike të automatizuara. Përdorimi i sistemit Moodle është një metodë por kjo zhvillohet vetëm për një nivel të ulët kreditesh. UAL përdor sekretimin e provimeve. Provimet me shkrim bëhen të sekretuar. Kjo u konfirmua dhe në takimin e zhvilluar me autoritetet drejtuese dhe studentët.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.2. Rregullore e FSHMT;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Kontrolli i dijeve të përvetësuara nga studenti bëhet nëpërmjet testeve, detyrave të kursit, të cilat zhvillohen gjatë semestrit ku zhvillohet lënda ose moduli përkatës dhe nëpërmjet provimeve përfundimtare. Studentëve, nga ana e pedagogëve të lëndës, u bëhet e ditur në fillim të lëndës mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është pjesë e syllabusit të lëndës ose modulit përkatës që iu dorëzohet studentëve. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe komulative me pikë. Pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të lëndës u shtohen pikët e provimit përfundimtar duke përcaktuar totalin e pikëve të grumbulluara nga studenti bashkë me notën përkatëse. Vlerësimi i njohurive zhvillohet duke përdorur metoda të ndryshme dhe realizohet nëpërmjet vlerësimit gjithëvjeter (përkatësisht semestral) të punës në auditor, përgatitjes së detyrave të kursit, rezultateve laboratorike, praktikës profesionale dhe provimit përfundimtar. Autoritetet drejtuese raportuan një system 10 (ndjekje e lëndës dhe pjesmarrja) /20 (detyrimet specifike psh. Detyra kursi, orë laboratorike etj. /10 (testimet gjatë vitit) /60 (provimi</p>




	<p>përfundimtar) për secilën nga metodat e ndryshme. Këto u konfirmuan dhe në takimet e zhvilluara në UAL.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.6. Rregullore provimi;</i></p> <p><i>16. Rregullore e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi;</i></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>27.1. SYLLABUS V1;</i></p> <p><i>27.2. SYLLABUS V2;</i></p> <p><i>27.3. SYLLABUS V3;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në rastet që është e nevojshme, pedagogët bëjnë komente dhe u japin feedback studentëve për provimit. Kur studentët kanë nevojë për sqarim ata kontaktojnë pedagogun e lëndës i cili u jep sqarimet e nevojshme.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Studenti gjatë kohës së zhvillimit të provimit, i ndalohej të komunikojë me studentët e tjerë apo me pedagogun, për çfarëdolloj arsyeje qoftë. Provimi dhe vlerësimi i tij është individual. Studentit nuk i lejohet të kopjojë në çfarëdolloj forme apo mënyre. Nëse ai tenton të bëjë një veprim të tillë pedagogu e nxjerrë jashtë nga provimi dhe vlerësimi i tij është negativ. Studenti, në sallën e provimit, duhet të ketë me vete mjetet që do të shkruajë dhe nuk lejohet të marrë me vete libra ose materiale të tjera vetëm në rastet kur janë të atautorizuara me parrë nga pedagogu i lëndës. Studenti që sjell me vete materiale të paautorizuara në sallën e provimit i merren nga pedagogu dhe i kthehen pas mbarimit të provimit. Ndërsa, kur këto materiale të paautorizuara, si pasojë e fshehjes nga ana e studentit, kapen gjatë zhvillimit të provimit apo në kohën që studentit u referohet atyre, i merren materialet dhe studentit përjashtohet nga provimi. Studentët në përfundim të provimit</p>




	<p>dorëzohen tezën dhe përgjigjet e saj pedagogut të lëndës dhe njëkohësisht firmosin në fletën e dorezimit (e provimeve). Në përfundim të kohës së provimit pedagogu urdhëron mbylljen e provimit, studentët nuk shkruajnë, qëndrojnë në bankë derisa ai t'u mbledhë provimet dhe studentët të firmosin listën e dorezimit të provimit. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve përcaktohen dhe në Rregulloren e Njesisë Kryesore (neni 40) dhe neni 15 i Rregullores së programit të studimit. Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin edhe anëtarë të personelit akademik me përjashtim të përgjegjësit të departamentit, dekanit e personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga dekani ose Rektori për të kryer kontroll. Studenti paraqitet në provim me dokument identifikimi me fotografi. Në rastet kur studentit nuk paraqitet në provim ose shlyrje, ai shpallet jokalue në atë lëndë ose modul. Rezultatet e studentit shënohen në regjistrin e sekretarisë mësimore dhe në sistemin kompjuterik të shërbimit dhe informimit të studentëve sipas adresës personale elektronike.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.2. Rregullore e FSHMT;</i></p> <p><i>3.6. Rregullore provimi;</i></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e provimeve duhet të depozitohen në sekretarinë mësimore brenda një afati një javor, nga data e dhënies së provimit: Me marrjen e rezultateve, sekretaria mësimore bën hedhjen e tvre në sistemin kompjuterik përkatës. Në përfundim të fazës finale të rishikimit të vlerësimit të provimit, sekretaria mësimore bën njoftimin përfundimtar. Në rast se do të ketë kontestime për përgjigjet e marra nga ana e studentëve, sekretaria mësimore vë në dijeni dekanatin.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.6. Rregullore provimi;</i></p> <p><i>Vizita në sekretarinë mësimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat</p>	<p>Studentët informohen për rezultatet e provimit në sistemin elektronik të UAL-së. Kjo u konfirmua në takim me studentët dhe sekretarinë mësimore. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të procedurës të zhvillimit të provimit si dhe për rezultatit e provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim sekretarisë mësimore. Kur studentit nuk është dakord me vendimin e marrë</p>




<p>që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>nga departamenti/strukura përgjegjëse, ka të drejtë të apelojë këtë vendim brenda 48 orëve nga njofimi i tij në dekanatin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Disa nga studentët që morrën pjesë në takim raportuan se janë ankuar për notë që kanë marrë dhe i janë drejtuar drejtueses së Departamentit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.6. Rregullore provimi;</i></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të apelojë për vlerësimin në provim edhe në nivele drejtuese të tjera (Departament, Dekan, Rektor, Administrator) kur ai nuk është i bindur edhe nga rishikimi dhe rivlerësimi që i ka bërë pedagogu i lëndës. Prej tyre ai/ajo merr përgjigje perfundimtare me shkrim. Të gjitha këto dokumentohen dhe arkivohen. Nuk u raportuan raste të tilla në institucion. Sekretaria mësimore pas hedhjes së rezultateve të provimeve në regjistrat përkatës, harton dhe përpunon statistika të ndryshme në lidhje me kalueshmërinë, sipas kërkesave të drejtuesve të institucionit apo të Ministrisë së Arsimit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.6. Rregullore provimi;</i></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>Takim me studentët;</i></p> <p><i>Vizita në sekretarinë mësimore.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe komulative me pikë. Pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të lëndës u shtohen pikët e provimit perfundimtar duke përcaktuar totalin e pikëve të grumbulluara nga studentit bashkë me notën përkatëse. Institucioni nuk përdor sisteme kontrolli elektronike të automatizuara. Kontrolli i dijeve të përvetësuara nga studentit bëhet nëpërmjet testeve, detyrave të kursit, të cilat zhvillohen gjatë semestrit ku zhvillohet lënda ose moduli përkatës dhe nëpërmjet provimeve perfundimtare. Në rastet që është e nevojshme, pedagogët bëjnë komente dhe u japin feedback studentëve për provimit. Rezultatet e provimeve duhet të depozitohen në sekretarinë mësimore brenda një afati një javor, nga data e dhënies së provimit. Studentët informohen për rezultatet e provimit në sistemin elektronik të UAL-së. Studenti</i></p>





	<i>ka të drejtë të ankohet për shkelje të procedurës të zhvillimit të provimit si dhe për rezultatin e provimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi është aktiv që prej vitit 2010. Ai është akredituar më përpara. Programi ofrohet në tre vite akademik, ka në total 180 ECTS dhe studentët në përfundim të studimeve fitojnë titullin Fizioterapist. Objektivat dhe kurrikula e Bachelor në Fizioterapi janë përgatitur për t'ju ofruar studentëve njohuri të thella dhe të plota mbi punën, parimet dhe metodikën e punës në specialitetin e fizioterapisë, në mënyrë që studentët të përfitojnë një formim të plotë duke u aftësuar në shkencën rehabilituese. Programi Bachelor në Fizioterapi synon të formojë të diplomuarit fizioterapeut si profesionistë të cilët do të luajnë një rol të rëndësishëm në cilësinë e rehabilitimit fizioterapeutik dhe sigurinë e pacientit. Ata do të jenë zgjedhja e parë si partnerë për punë ndërdisiplinore në kujdesin ndaj pacientit, promovimin dhe ruajtjen e shëndetit, si dhe parandalimin e sëmundjeve dhe formimin e specialistëve me njohuri të nevojshme shkencore, vlera etike dhe morale në aplikimin e profesionit të Fizioterapistit. Programi mundëson përgatitjen e profesionistëve në fizioterapi, me njohuri e kompetenca të nevojshme fizioterapeutike profesionale teorike dhe praktike, të aftë të punojnë në sektorin e rehabilitimit, në përputhje me normat e paracaktuara nga Komuniteti European. Studentët bëhen të aftë të njohin fenomenet thelbësore biologjike, hereditare, fiziopatologjike si dhe ndërthurjen e psikologjisë së individit dhe realitetit socio-ambiental. Afësimi i studenteve për t'u përfshirë në aktivitete konkrete mjekësore dhe për tu angazhuar në funksione të ndryshme në sektorin publik apo privat arrihet përmes programit të studimit. Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studentët fitojnë në këtë program studimi detajohen në syllabuset e lëndëve.






	<p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>24. Program i permbledhur;</i></p> <p><i>27.1. SYLLABUS V1;</i></p> <p><i>27.2. SYLLABUS V2;</i></p> <p><i>27.3. SYLLABUS V3.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit përmban lëndë të cilat u mundësojnë studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta. Studentët kanë mundësinë të zhvillojnë gjuhë të huaj (anglisht – terminologji), ndërsa ka dhe gjuhë të huaj si lëndë me zgjedhje (italisht, frëngjisht). Informatika është një lëndë e këtij program studimi ndërsa përfshihen po ashtu Bioetika, Sociologji e Përgjithshme dhe Mjekësore, dhe Psikologji.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave për programin e studimit (Tabelat 15 dhe 27).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Njohuritë dhe aftësitë që studentët fitojnë në secilën lëndë/modul prezantohen në syllabuset respektive. Në fund të lëndës/modulit, dhe më specifikisht në orën e fundit të leksionit, pedagogu u vë në pah studentëve çështjet më të rëndësishme si dhe ku ata duhet të fokusohen. Kjo u konfirmua nga stafi akademik dhe studentët. Një student raportoi se kjo është diçka e rregullt që ndodh duke dhënë si shembull që është e vështirë të lexosh në fund dhjetra-qindar faqe kur ke vetëm pak kohë.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>27.1. SYLLABUS V1;</i></p> <p><i>27.2. SYLLABUS V2;</i></p> <p><i>27.3. SYLLABUS V3;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe</p>	<p>Studentët zhvillojnë orë teorike dhe praktike. Ka një ndërthurje të programit me leksione, seminare, orë laboratorike, detyra kursi dhe praktikë profesionale. Sipas planit mësimor, në total parashikohen:</p> <p>970 orë leksion;</p>




<p>praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>288 orë seminare; 18 orë ushtrime; 130 orë laboratore; 510 orë praktikë profesionale; 14 orë projekte; 84 orë provimi i formimit;</p> <p>Në total parashikohen 2014 orë në auditor dhe 2486 jashtë auditorit (4500 orë në total). Një nga studentët raportoi se i pëlqen mënyra e mësimdhënies e kombinuar më praktikën sepse i bën të mundur implementimin e njohurive të marra. Mësimdhënia zhvillohet me në qendër studentin. Stafi akademik raportoi se përdor metoda të ndryshme përfshirë këtu bashkëbisedimet, punën individuale, simulimet (duke përdorur një krevat dhe një nga studentët bën pacientin dhe tjetri të sëmurin), case-study, foto-video të cilat studentët komentojnësi etj. Këto metoda u konfirmuan dhe nga studentët në takimin e zhvilluar. Mobiliteti i studentëve është i mundur.</p> <p><i>Asnjë nga studentët që morrën pjesë në takim nuk kishte kryer ndonjë mobilitet në IAL jashtë Shqipërisë. GVJ e konsideron këtë si një pikë të cilën UAL duhet të punoj më shumë.</i></p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabela 15, 18);</i></p> <p><i>27.1. SYLLABUS V1;</i></p> <p><i>27.2. SYLLABUS V2;</i></p> <p><i>27.3. SYLLABUS V3;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>Rregullisht Njësia Bazë organizon orë të hapura me leksione, workshope etj. Kjo u konfirmua në takimin me stafin akademik si dhe studentët. Ata dhanë dhe shëmbullin e vizitës së një pedagogu nga Spanja ndërsa stafi akademik të disa profesorëve italianë. Një shëmbull i një aktiviteti për HIV. Në tabelën 22 jepen aktivitete të ndryshme të organizuara nga UAL. Organizimi i këtyre aktiviteteve është positive, po, <i>GVJ</i></p>

<p>brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p><i>konsideron se është e rëndësishme të organizohen më shumë aktivitete të tilla në fushën e Fizioterapisë. Një praktikë e mirë që Institucioni ndjek janë orët e hapura dhe relacionet që përgatit stafi akademik në momentin e përfundimit të një mobiliteti.</i></p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabelat e te dhenave per programin e studimit (Tabela 22); Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesis Bazë; Takim me stafin akademik; Takim me studentët</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi është aktiv që prej vitit 2010. Ai është akredituar më përpara. Programi ofrohet në tre vite akademik, ka në total 180 ECTS dhe studentët në përfundim të studimeve fitojnë titullin Fizioterapist. Objektivat dhe kurrikula e Bachelor në Fizioterapi janë përgatitur për t'ju ofruar studentëve njohuri të thella dhe të plota mbi punën, parimet dhe metodikën e punës në specialitetin e fizioterapisë. Programi i studimit përmbanë lëndë të cilat u mundësojnë studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta. Njohuritë dhe aftësitë që studentët fitojnë në secilën lëndë/modul prezantohen në syllabuset respektive. Studentët zhvillojnë orë teorike dhe praktike. Asnjë nga studentët që marrën pjesë në takim nuk kishte kryer ndonjë mobilitet në IAL jashtë Shqipërisë. GVJ e konsideron këtë si një pikë të cilën UAL duhet të punoj më shumë. GVJ konsideron se është e rëndësishme të organizohen më shumë aktivitete në fushën e Fizioterapisë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi III.5**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**




<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në përfundim të kursit të plotë të studimeve studentët kanë të drejtë të diplomohen për të fituar titullin përkatës profesional. Diplomimi behet me provim formimi profesional për programet e ciklit të parë (neni 43 i Rregullores së Institucionit dhe neni 31 i Rregullores së Njesisë Kryesore).</p> <p><i>Institucioni nuk ka një rregullore specifike për provimin e përgjithshëm përfundimtar. <u>GVJ konsideron se UAL duhet të hartoj një rregullore të tillë pasi informacioni që jepet në rregulloret aktuale nuk është i mjaftueshëm.</u></i></p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.1. Rregullore e Universitetit;</i></p> <p><i>3.2. Rregullore e FSHMT;</i></p> <p><i>16. Rregullore e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi;</i></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesen e Njesisë Bazë.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Pedagogët e lëndëve të programit Bachelor në “Fizioterapi” përgatisin pyetjet për provimin përfundimtar të studentëve. “Banka e pyetjeve” të mbledhura u vendoset në dispozicion studentëve që janë për diplomim. Studentët raportuan se i kanë marrë pyetjet përmes platformës elektronike të UAL, grupit në WhatsApp si dhe nga Kujdestari i lëndës.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Komisioni i provimit të diplomës vlerëson njohuritë e studentëve të marra në të tre vitet e studimit në bazë të pyetjeve të vëna në dispozicion nga pedagogu i secilës lëndës. Kjo u konfirmua nga stafi akademik dhe nga studentët të cilët kishin marrë bankën e pyetjeve. Kjo procedurë nuk është e pasqyruar në rregulloret aktuale ose në rregullore specifike.</p> <p><i>Për këtë arsye, <u>GVJ sugjeron hartimin e një Rregullore të posaçme për procedurën e diplomimit.</u></i></p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Studentët në përfundim të këtij program studimi diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar dhe jo me punim diplome.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentët në përfundim të këtij program studimi diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar dhe jo me punim diplome. Studentët nuk kanë nevojë për të kryer matje, analiza etj.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi i diplomës (provimit) nga komisioni bëhet me notë (neni 11, pika 2 e Rregullores së Programit të studimit).</p> <p><b>Evidenca:</b> <i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studentët, që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi, pajisen me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar. Diploma plotësohet me të dhënat e sakta të studentit. Ajo nënshkruhet nga dekani i fakultetit dhe Rektori i UAL. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e UAL-së. Respektivisht, sipas formës së studimit lëshohen diplomat e ciklit të parë. Universiteti i pajis studentët që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi brenda afateve kohore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar. Diplomat për ciklin e parë shoqërohen me suplementin e diplomës.</p>




	<p>Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës evropiane të arsimit të lartë. Përmbajtja dhe forma e diplomës dhe e suplementit të diplomës përcaktohen nga Senati akademik në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin (neni 52 i Rregullores së Institucionit).</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.1. Rregullore e Universitetit;</i></p> <p><i>25. Format diplome dhe suplemenrt Ba ne Fizio.</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Në përputhje me legjislacionin në fuqi sekretaria mësimore ruan të gjithë dokumentacionin e nevojshëm (neni 103 i Statutit dhe neni 91 i Rregullores së Institucionit). Detyrimet e sekretarisë mësimore përcaktohen në Rregulloren e saj. Gjatë vizitës në UAL, GVJ konstatoi se dokumentacioni ruhej sipas akteve ligjore.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>1. Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>3.1. Rregullore e Universitetit;</i></p> <p><i>3.4. Rregullore e Sekretarisë;</i></p> <p><i>Vizita në sekretarinë mësimore.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Në përfundim të kursit të plotë të studimeve studentët kanë të drejtë të diplomohen për të fituar titullin përkatës profesional. Diplomimi behet me provim formimi profesional për programet e ciklit të parë. Institucioni nuk ka një rregullore specifike për provimin e përgjithshëm përfundimtar.</i></p> <p><i>GVJ konsideron se UAL duhet të hartoj një rregullore të tillë pasi informacioni që jepet në rregulloret aktuale nuk është i mjaftueshëm. Pedagogët e lëndëve të programit Bachelor në "Fizioterapi" përgatisin pyetjet për provimin përfundimtar të studentëve. Vlerësimi i diplomës (provimit) nga komisioni bëhet me notë. Studentët, pajisen me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar. Në përputhje me legjislacionin në fuqi sekretaria mësimore ruan të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																											
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të DVV, FSHMT dhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë njësitë përgjegjëse për programin e studimit, për realizimin e programit të studimit ka angazhaur staf akademik në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, dhe nivelin e kualifikimit akademik dhe ekspertizës për drejtimin e programit Bachelor në Fizioterapi. Në programin e studimit prej vitesh është angazhaur staf akademik me kontratë me grada dhe tituj shkencor në fushën e fizioterapisë dhe përvojë klinike. Titullarët e lëndëve mbajnë minimalisht titullin Profesor i Asociuar, ndërkohë që vihet re që stafi akademik i kategorisë asistentë lektorë me MSc si PAE dhe PAK në tre vitet e fundit zë numrin më të madh të stafit të angazhuar në programin e studimit.</p> <p><i>GVJ konstaton se institucioni për të garantuar qëndrueshmërinë e cilësisë së programit të studimit BSc. Fizioterapi duhet të hartoj politika dhe strategji efektive për rekrutim dhe mbajtje të stafit akademik me grada dhe tituj.</i></p> <p>Për sa i takon personelit akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi, për gjatë viteve akademike, të dhënat mbi kualifikimin shkencor janë si vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>6</td> <td>1</td> <td>6</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table>	Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-	Prof. Asoc.	6	1	6	2	3	2
Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024																							
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																						
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-																						
Prof. Asoc.	6	1	6	2	3	2																						

	Dr./PhD.	4	3	4	5	9	5										
	SPA	4	-	4	-	4	-										
	Msc.	11	5	12	1	12	2										
	<b>Totali</b>	<b>25</b>	<b>9</b>	<b>26</b>	<b>8</b>	<b>28</b>	<b>9</b>										
	<p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave të Fizioterapisë.pdf;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi drejtuesin e njësisë kryesore, bazë, stafin akademik dhe ndihmësakademik.</i></p>																
<p><b>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</b></p>	<p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit përbëhet si nga personel akademik efektiv, dhe nga personel akademik me kontratë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV, u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për vitin akademik 2023-2024, është si më poshtë vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>23-24</td> <td>2924</td> <td>2524</td> <td>400</td> <td>86% / 14%</td> </tr> </tbody> </table> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave të Fizioterapisë.pdf, Tabela 3.2;</i></p> <p><i>23. Tabelat e stafit të programit, Tabela 5,5.1,5.2;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi drejtuesin e njësisë kryesore, bazë, stafin akademik dhe ndihmësakademik.</i></p>							Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	23-24	2924	2524	400	86% / 14%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)													
23-24	2924	2524	400	86% / 14%													
<p><b>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</b></p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizitës në institucion, rezulton se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka mbi 5 vjet që janë në institucion të angazhuar në programin e studimit. Programi dëshmon qëndrueshmëri në angazhimin e tij në këtë program studimi, pasi. Universiteti Aldent ka garantuar këtë qëndrueshmëri edhe në sajë të politikave dhe kritereve të rekrutimit dhe trajtimit të stafit. Këto kritere janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të reflektuara në kontratën e punës dhe dosjen individuale të stafit akademik. Një shembull i politikave mbajtëse është dhe ofrimi falas i siguracionit shëndetësor privat krahas siguracionit shëndetësor publik.</p> <p>Ky shërbim i mundëson stafit akademik kryerjen e ekzaminimeve dhe vizitave falas një herë në vit dhe ulje të tarifës së shërbimeve gjatë gjithë vitit. Kjo praktikë, nga GVJ konsiderohet si shembull i praktikës së mirë.</p>																



	<p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>5. Kontratë model PAE dhe PAK;</i></p> <p><i>28.1. Cv.Bsc.Fizioterapi;</i></p> <p><i>28.2. Cv_PAK_Fizioterapi;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë për zgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Aldent, për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit BSc.Fizioterapi ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet rregullatore të brendshme dhe nevojat e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Zyra e Burimeve Njerëzore shpall vendet vakante të punës me kriteret përkatëse në faqen zyrtare të institucionit <a href="https://ual.edu.al/ual.edu.al/">https://ual.edu.al/ual.edu.al/</a>. Dosjet e aplikantëve vlerësohen nga një komision ad-hoc i përberë nga 5 anëtarë ku 3 prej tyre janë anëtarë të departamentit ku ofrohet programi i studimit. Skema e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve është përcaktuar dhe shpallur paraprakisht. Sipas pikëzimit final kryhet klasifikimi i kandidatëve dhe merret vendimi përkatës. Emërimi i kandidatit fitues kryhet me urdhër të brendshëm të Rektorit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>4. Procedura e rekrutimit të stafit;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesin e njësisë bazë dhe përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Realizimi i orëve laboratorike dhe mirëmbajtja e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore për programin e studimit BSc. Fizioterapi kryhet nga personeli i kategorisë MSc. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përgjegjës për programin e studimit në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve përfshihet në procesin e rekrutimit të stafit si akademik dhe ndihmës akademik. Kriteret e punësimit përcaktohen dhe shpallen paraprakisht në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Evidenca 3.7. Rregullore e Burimeve Njerëzore;</i></p> <p><i>4. Procedura e rekrutimit të stafit;</i></p> <p><i>28.1. 2. CV e stafit të programit Bsc.Fizioterapi;</i></p>

	<i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesin e njësisë bazë dhe përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	<p>Mbledhja, ruajtja dhe përditësimi i të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit BSc. Fizoterapi, në Universitetin Aldent kryhet çdo vit akademik në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloreve të brendshme institucionale. Njësia përgjegjëse institucionale për këtë proces është Zyra e Burimeve Njerëzore. Përveç të dhënave personale, të dhënat përfshijnë dhe informacion për aktivitetin mësimor dhe kërkimor shkencor të stafit të angazhuar në programin e studimit. Çdo anëtar i stafit, akademik, ndihmësakademik dhe administrativ ka dosjen personale të stafit që përditësohet periodikisht me informacionin sipas formatit standard të miratuar.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.7. Rregullore e Burimeve Njerëzore;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore.</i></p>
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>UAL ka nënshkruar marrëveshje e instaluar bashkëpunime me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani si Spitali Universitar i Traumës, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, QSUT për të angazhuar personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve të programit BSc. Fizoterapi gjatë praktikës profesionale. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve mbikëqyrësit dhe monitoruesit e studentëve gjatë praktikës profesionale janë fizioterapistë që punojnë në këto mjedise klinike. Nga këto institucione është dhe pjesa e stafit akademik që është i angazhuar në realizimin e orëve laboratorike në mjediset e institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>9.1. Marrëveshjet me institucione arsimore;</i></p> <p><i>9.2. Marrëveshjet me institucione shëndetësore;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik.</i></p>
<b>Kriteri 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin	Në bazë të marrëveshjeve të UAL, personeli mbikëqyrës apo të emërtuar edhe si referentët e praktikës në ambientin pritës që

<p>pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>angazhohet në realizimin e praktikave profesionale të programit të studimit BSc. Fizioterapi, ndihmojnë studentët jo vetëm në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me praktikën por janë pjesë aktive edhe në vlerësimin e performancës së tyre gjatë këtij procesi. Referentët e praktikës, në fillim të modulit të praktikës njoftohen zyrtarisht për kalendarin e praktikës klinike, u vihet në dispozicion lista e studentëve që do të ndjekin e monitorojnë dhe objektivat specifike për cdo shërbim. Referentët e praktikës në përfundim të modulit dorëzojnë në institucion formularin e vlerësimit të praktikës profesionale që përfshin frekuentimin, paraqitjen, angazhimin dhe seriozitetin e studentëve në kryejn e praktikës profesionale.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>18. Rregullore e praktikave;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Personeli akademik që mbulon programin e studimit BSc. Fizioterapi përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit. Për grantimin e qëndrueshmërisë dhe standardeve të mësimdhënies, UAL ka hartuar dhe implementuar politika që lidhen kryesisht me mbajtjen e stafit të angazhuar në programin e studimit dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera të kujdesit klinik dhe jo vetëm për realizimin e orëve të praktikës profesionale dhe orëve laboratorike.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të</p>	<p>UAL disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit BSc. Fizioterapi dhe moduleve përkatëse. Infrastruktura në funksion të mësimdhënies është rreth 8500m<sup>2</sup> me ambiente parkimi dhe interaktiviteti me sipërfaqe rreth 2500m<sup>2</sup>. Mjediset e mësimdhënies përfshijnë</p>




<p>numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>salla leksionesh, seminaresh, laboratorë me kapacitet nga 20-120 studentë. Kampusi i UAL është ndërtesë e re (korpusi C+D) me ambiente të dedikuara me infrastrukturë moderne dhe standard të lartë logjistik. Hapësirat e mjediseve mësimore janë të mjaftueshme, të ndricuara me dritë natyrore dhe të pajisura me logjistikën përkatëse në varësi të funksionit, të pajisura me sistemin e mbrojtjes nga zjarri, ashensorët, shkallët e emergjencës, barriera arkitektonike për personat me aftësi të kufizuara etj. Godinat janë të pajisura me sistem qendror kondicionimi dhe nyje hidrosanitare të mjaftueshme (76 bokse) për numrin e studentëve përfshirë dhe 5 tualete për personat me aftësi të kufizuara dhe 7 tualete për stafin.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>13. Planimetria e kampusit;</i></p> <p><i>13.1. Relacion infrastrukture;</i></p> <p><i>Vizita në mjediset e institucionit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion u konstatua se UAL disponon mjedise të mjaftueshme për të gjitha format e mësimdhënies si leksione, seminare, salla laboratorike. Sallat mësimore janë të pajisura me mjetet e nevojshme audiovizive dhe didaktike si kompjutera, video-projektorë, mikrofonë, tabela dhe internet. Në ndërtesën e re, që përbëhet nga korpusi C+D në funksion të mësimdhënies dhe programit të studimit janë në dispozicion 24 laboratorë që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik për të gjitha programet e studimit, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. UAL ka energji të panderprerë, dhe është i pajisur me gjenerator dhe invertera për sistemin kompjuterik në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>13. Planimetria e kampusit;</i></p> <p><i>13.1. Relacion infrastrukture;</i></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave për programin e studimit, Tabela 7;</i></p> <p><i>Vizita në mjediset e institucionit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë</p>	<p>Laboratorët e UAL përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues në tërësi të programit të studimit BSc. Fizioterapi. Laboratorët në funksion të programit të studimit si laborator ortopedik,</p>




<p>aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>neurologjik dhe pediatrik janë të ndara në varësi të moduleve dhe teknikave rehabilituese të aplikueshme nga programi i studimit. Në mbështetje të programit të studimit, janë edhe laboratorët klinikë-diagnostikë të kompletuar me aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme si laborator i Histologjisë, Mikrobiologjisë, Imunologjisë, Biokimisë dhe Hematologjisë. Në mjediset laboratorike studentët kanë mundësinë të diskutojnë raste klinike të improvizuara nga pedagogët si dhe të praktikojnë lirisht në kushtet e sigurisë cdo procedurë fizioterapie për të cilën nuk ndihen mjaftueshëm të aftë. Laboratorët pajisen vazhdimisht me mjete konsumi dhe aparatura të reja në bazë të nevojave dhe kërkesave të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit BSc.Fizioterapi.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>20. Përshkrim i laboratoreve në funksion te programit;</i></p> <p><i>21. Procedura e blerjes së materialeve për laboratore;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin akademik;</i></p> <p><i>Vizita në mjediset e institucionit, laboratorët.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>UAL disponon laboratorin e teknologjisë së informacionit, i cili përmbush standardet bashkëkohore për zhvillimin e mësimdhënies me cilësi për programin e studimit BSc. Fizioterapi. Ky laborator është i pajisur me kompjutera të lidhura me internetin dhe programe profesionale dhe statistikore si SPSS që mund të përdoren si nga studentët dhe nga stafi akademik në funksion të veprimtarisë së mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimore-shkencore.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>23. Tabelat e të dhënave për programin e studimit, Tabela 7;</p> <p>Vizita në mjediset e institucionit, laboratorin i informatikës.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAL ka vënë në dispozicion të programit të studimit BSc. Fizioterapi mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit. Infrastruktura dhe mjediset e mësimdhënies janë bashkëkohore me standarde dhe të pajisura me logjistikën përkatëse.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

**Standardi IV.3**

**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>UAL vendos në dispozicion të studentëve literaturën bazë dhe ndihmëse të nevojshme për programin e studimit BSc. Fiaoterapi. Që ditën e parë të cdo moduli, lektori i lëndës u prezanton studentëve syllabusin e lëndës në të cilin është përracktuar dhe literature bazë dhe ndihmëse e modulit. Literatura e detyruar përgatitet nga lektorët e lëndëve në formën e ciklit të leksioneve të cilat studentët kanë mundësi që ta marrin fizikisht ose elektronikisht nëpërmjet platformës UAL e-Learning.</p> <p>Lektorët e programit BSc. Fizioterapi për të përgatitur ciklin eleksioneve bazohen në librarinë online të shtëpisë botuese Elsevier me akses falas për të gjithë stafin dhe studentët e programeve të shkencave mjekësore. Miratimi i ciklit të leksioneve të literaturës bazë kryhet në departmentin përgjegjës ku ofrohet programi I studimit pas paraqitjes së kërkesës nga lektori përkatës.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>26. Literatura e aprovuar e programit të studimit;</i>  <i>Evidenca shtesë pas vizitës- Përditësim literature;</i>  <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, dy njësitë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit në UAL, raportojnë për gjendjen e literaturës që përdoret dhe përditësimet të nevojshme të saj. Në kuadër të këtij kriteri, në dy vitet e fundit biblioteka është pasuruar me literaturë të huaj të fushës së fizioterapisë dhe në bazë të saj janë përgatitur ciklet e leksioneve për studentët. Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit kryen përditësimet të literaturës bazë të modulit me referenca të 5 viteve të fundit. Ciklet e leksioneve të përditësuar të hartuara, miratohen për përdorim nga njësia</p>




	<p>bazë në fillim të vitit akademik që më pas pasqyrohen në syllabuset e lëndëve.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>12. Biblioteka;</i></p> <p><i>26. Literatura e aprovuar e programit të studimit;</i></p> <p><i>Evidenca shitesë pas vizitës- Përditësim syllabusi;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UAL ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit bibliotekën mësimore dhe garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit BSc. Fizioterapi. Biblioteka nga ana e infrastrukturës dhe logjistikës ka standarde të larta bashkëkohore. Biblioteka ka rregulloren e brendshme të funksionimit, në të cilën janë përcaktuar ndër të tjera, mënyra e tërheqjes, shfrytëzimit dhe trajtimit të librave. Pavarësisht nga lloji dhe fusha e programit të studimit që ndjekin, të gjithë studentët janë të lirë të shfrytëzojnë fondin e disponueshëm të bibliotekës për shkencat mjekësore dhe jo vetëm pa limit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>12-Biblioteka;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe personin përgjegjës të bibliotekës.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>UAL disponon një bibliotekë të pasur me tekste mësimore dhe literaturë bazë, ndihmëse fizike në gjuhën shqipe dhe të huaj të mjaftueshme për programin e studimit BSc. Fizioterapi. Në dispozicion të studentëve janë rreth 10 mijë tituj. Rreth 16 mijë libra dhe revista shkencore janë të disponueshme në bibliotekë për të gjithë studentët. Në ambjentet e bibliotekës, fondi fizik i librave është klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave ndërkohë që informatizimi i tyre mundëson informacion të gjerë mbi materialin në brendësi të librit. Biblioteka përbëhet nga dy salla me 75 poste leximi dhe 50 poste me kompjutera të pajisura me internet.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>12. Biblioteka;</i></p> <p><i>13.1. Relacion infrastrukture;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me personin përgjegjës të bibliotekës.</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UAL u ka krijuar të gjithë studentëve, përfshirë dhe studentëve që ndjekin programin BSc. Fizioterapi kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. Institucioni është i abonuar prej disa vitesh në bibliotekën online të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Hinari. Njëpërmjet kompjuterave të instaluar në ambjentet e bibliotekës dhe të pajisur me Internet, studentët dhe stafi akademik mund të aksesojnë pa limit në bazën e të dhënave të kësaj biblioteke.</p> <p>Prej periudhës 2018-2019 institucioni ka mundësuar aksesin edhe në U-library. Ndërkohë që të gjithë studentët dhe stafi mund të shfrytëzojnë edhe bibliotekën dhe infrastrukturën e institucioneve partnere të marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit të instaluar si libra, botime revista shkencore të printuara dhe online.</p> <p>Mundësia që studentët dhe stafi akademik i UAL ka në shfrytëzimin pa limit dhe pa pagesë të literaturës mjekësore nëpërmjet bibliotekës Hinari konsiderohet nga GVJ si shembull i praktikës së mirë.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave për programin e studimit, Tabela 8;</i></p> <p><i>12. Biblioteka;</i></p> <p><i>13.1. Relacion infrastrukture;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me personin përgjegjës të bibliotekës.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e UAL përbëhet nga dy salla me 75 poste leximi dhe 50 poste me kompjutera të pajisura me internet që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët, përfshirë dhe studentët e programit BSc. Fizioterapi. Ndërkohë që biblioteka kryen dhe digjitalizimin e skedarëve dhe shkëmben informacion me biblioteka të tjera akademike brenda dhe jashtë vendit. Fondi i bibliotekës online mbulon kryesisht literaturë për programet e shkencave mjekësore të aksesueshme nga të gjithë studentët dhe stafi akademik i UAL. Fondi digjital dhe fizik i bibliotekës pasurohet vazhdimisht me disertacionet botimet shkencore dhe tekstet mësimore të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave për programin e studimit, Tabela 8;</i></p> <p><i>12. Biblioteka;</i></p>



	<p><i>13.1. Relacion infrastrukture;</i> <i>Vizita në institucion, takimi me personin përgjegjës të bibliotekës.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e UAL është e pajisur me poste leximi dhe kompjutera me Internet që mundësojnë aksesin e studentëve të programit BSc. Fizioterapi në fondin fizik dhe online të saj në orare të përshtatshme në përputhje me orarin e tyre të mësimit. Ambjentet e bibliotekës janë të pajisura dhe me videoprojektor që krijojnë mundësinë për prezantim të detyrave apo të projekteve të kursit. Biblioteka është në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik çdo ditë për të shfrytëzuar fondin e saj digjital, fizik dhe mjediset për lexim dhe organizim aktiviteteve.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave për programin e studimit, Tabela 8;</i> <i>12. Biblioteka;</i> <i>13.1. Relacion infrastrukture;</i> <i>Vizita në institucion, takimi me personin përgjegjës të bibliotekës.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka e UAL dhe njësitë përgjegjëse të programit, përkatësisht Departamenti i Infermierisë e Fizioterapisë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e të gjitha programeve të studimit. Në shfrytëzimin e bibliotekës, studentët orientohen edhe nga stafi akademik i programit të studimit. Në përgjithësi, shfrytëzimi i llojit të literaturës është e lidhur edhe me vitin e programit të studimit që studentët janë duke ndjekur. Për shembull, studentët e vitit të parë të programit BSc. Fizioterapi shfrytëzojnë më shumë libra që lidhen me njohuri për anatóminë, fiziologjinë dhe bazat e fizioterapisë. Në vitin e dytë dhe të tretë studentët shfrytëzojnë literaturë më specifike të programit të studimit. Literatura përditësohet vazhdimisht bazuar në nevojat e stafit, studentëve dhe konsiderimeve shëndetësore bashkëkohore.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave për programin e studimit, Tabela 8;</i> <i>12. Biblioteka, librat e rinj;</i></p>




	<i>13.1. Relacion infrastrukture; Vizita në institucion, takimet me studentët, stafin akademik dhe personin përgjegjës të bibliotekës.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit BSc Fizioterapi përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies. Literatura disponohet në gjuhën shqipe dhe të huaj në saj të aksesimit pa limit dhe falas të çdo studenti dhe stafi akademik të UAL në biblioteka presitigjose mjekësore ndërkombëtare. Biblioteka, mjedisi mbështetës i mësimnxënies në UAL ka një infrastrukturë dhe logjistikë bashkëkohore, modern të shfrytëzueshme nga të gjithë, pa dallim si staf akademik dhe studentë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UAL disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit, FxEducation nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit BSc. Fizioterapi. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për pasqyrimin e aktivitetit të studentit gjatë gjithë periudhës së studimit. Institucioni disponon gjithashtu dhe platformën e UALe-Learning në Moodle e cila është gjithashtu në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies.  <b>Evidenca:</b> <i>7. Manual FxEducation; Vizita në institucion.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit	Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit FxEducation shërben edhe për administrimin e informacionit, dokumentacionit që lidhen me aktivitetin e stafit të angazhuar në programin e studimit BSc.Fizioterapi si stafit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.




<p>ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Aksesi i personave në sistemin e të dhënave është i kufizuar në varësi të kompetencave dhe pozicionit të punës. Çdo student i UAL ka llogarinë e vetë personale në sistem ku mund të aksesohet individualisht nëpërmjet të dhënave personale. Në sistemin FxEducation studentët informohen në lidhje me performacën e tyre akademike dhe çdo informacion e veprimtari tjetër që ka lidhje me programin e studimit si regjistrimi online për provimet në sezona jo të rregullta si vjeshtë, mbartje etj. Studentët kanë mundësi të aksesojnë platformën në çdo kohë dhe vend nëpërmjet portalit të studentit <a href="https://portalonline.ual.edu.al/">https://portalonline.ual.edu.al/</a> në faqen zyrtare Web të UAL <a href="https://ual.edu.al/ual.edu.al/">https://ual.edu.al/ual.edu.al/</a>. Aksesi në sistem u mundësohet edhe koordinatorëve të programeve të studimit në bazë të afateve të caktuara në sistem për kontrollin apo përditësimin e informacioneve të ndryshme.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>7. Manual FxEducation;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me studentët, stafin akademik dhe përfaqësues të Sekretarisë Mësimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit në UAL ka të integruar platformën UALe-Learning që mundëson komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve të programit të studimit BSc. Fizioterapi gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së studimeve. Nëpërmjet kësaj platforme studentët informohen jo vetëm për procesin mësimor por kryejnë edhe veprimtari të tjera që lidhen me mësimdhënien si leksione në distancë, webinarë, prezantim i detyrave të kursit, veprimtari kërkimore-shkencore etj. Çdo person, pjesë e UAL si staf akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentët disponojnë adresën individuale të emailit përkatësisht <a href="mailto:emër.mbiemër@ual.edu.al">emër.mbiemër@ual.edu.al</a> dhe <a href="mailto:emër.mbiemër@student.edu.al">emër.mbiemër@student.edu.al</a> për të aksesuar në platformën UALe-Learning.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>7. Manual FxEducation;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me studentët, stafin akademik dhe përfaqësues të Sekretarisë Mësimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të</p>	<p>Sistemi i menaxhimit, UALe-Learning garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale</p>




<p>aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>për organet dhe autoritetet drejtuese në lidhje me programin e studimit BSc. Fizioterapi. Mirëmbajtja, ndjekja dhe raportimi në kohë reale në organet drejtuese të institucionit mundësohet nga Zyra e IT-së. Sistemi ka ndërfaqe në gjuhën shqipe dhe angleze dhe është i aksesueshëm edhe në versionin mobile.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>7. Manual FxEducation;</i></p> <p><i>Vizita në institucion.</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Sipas verifikimit faqja zyrtare e UAL është: <a href="https://ual.edu.al/ual.edu.al/">https://ual.edu.al/ual.edu.al/</a>. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë, në dy gjuhë shqip dhe anglisht, mbi filozofinë dhe misionin, partneret, drejtimin dhe funksionimin, organigramën; guidat për studentët e ardhshëm të Universitetit si dhe mbi programet, së bashku me bio të detajuara të personelit akademik etj. Faqja e internetit të UAL është e lidhur edhe me platformën e-Learning dhe portalin e studentit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Faqja zyrtare e internetit UAL <a href="https://ual.edu.al/ual.edu.al/">https://ual.edu.al/ual.edu.al/</a>;</i></p> <p><i>Vizita në institucion.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAL disponon sistemin e brendshëm FxEducation të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit BSc. Fizioterapi. Sistemi ka të integruar edhe platforma të edukimit si UALe-Learning me akses individual për çdo anëtarë staf akademik, ndihmës akademik dhe studentë të UAL. Komunikimi në sistem është i mundur në kohë reale dhe menaxhohet nga Zyra e IT-së. Gjithashtu, UAL disponon dhe faqen zyrtare web ku aksesohet informacion nga çdo i interesuar për programin e studimit BSc. Fizioterapi dhe veprimtari të tjera që institucioni organizon.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.5**




**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UAL harton raportin vjetor financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit BSc. Fizioterapi dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit. UAL, bazuar në legjislacionin në fuqi ka autonomi financiare dhe përgatitja e buxhetit, shpërndarja dhe përdorimi i fondeve është kompetencë e plotë e institucionit dhe menaxhohet nga Bordi i Administrimit. Hartimi i projekt buxhetit nis me diskutimet dhe nevojat në nivel të njësisë bazë, konkretisht Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi përgjegjës për programin e studimit BSc.Fizioterapi. Buxheti diskutohet në edhe nivel fakulteti dhe merr miratimin përfundimtar në Rektorat.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave të Fizioterapisë, Tabela 24;</i></p> <p><i>21. Procedura e blerjes së materialeve për laboratorët;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimet me drejtuesitë e njësisë bazë dhe kryesore.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të</p>	<p>Plani i financimit të Departamentit Infermieri e Fizioterapi, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit BSc. Fizioterapi përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit, projektet etj. Plani financiar përfshin edhe kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm si dhe mundësitë e mbështetjes financiare të UAL si partner i vetëm apo bashkëfinansim.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave të Fizioterapisë, Tabela 24;</i></p> <p><i>21. Procedura e blerjes së materialeve për laboratorët;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimet me drejtuesitë e njësisë bazë dhe kryesore.</i></p>




realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	<p>UAL është universitet jopublik dhe si i tillë bazuar në legjislacionin në fuqi trajtohet si çdo biznes tjetër, përfshirë të drejtat dhe detyrimet ndaj punonjësve dhe shtetit. Në fund të çdo viti kalenderik, UAL harton pasqyrat financiare me anë të të cilave evidentohet gjendja e biznesit dhe masa e realizimit të projekt-buxhetit të parashikuar. Pasqyrat financiare të përpiluara si Pasqyra e pozicionit financiar (Bilanci Kontabël), Pasqyra e Performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe Shpenzimeve), Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare, dhe Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit Neto, kalojnë në proces auditimi të përvitshëm. Auditimi mundëson vlerësimin, dokumentimin dhe efektivitetin e planit financiar të hartuar të UAL.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave të Fizioterapisë, Tabela 24;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimet me drejtuesitë e njësisë bazë dhe kryesore.</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	<p>Në UAL, hartimi i projekt –buxhetit fillon në nivel të njësisë bazë, ndërkohë që raportet financiare vjetore që janë rezultat i auditit të brendshëm institucional i vihen në dispozicion njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, konkretisht Departamentit Infermieri e Fizioterapi. Dokumentimi i raporteve financiare kryhet nga Bordi i Administrimit ndërkohë që organet drejtuese të UAL, Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik, analizojnë të dhënat e raporteve financiare, evidentojnë problematikat në përdorimin e të ardhurave nga tarifat e studentëve në favor të procesit akademik dhe planifikojnë ndërhyrje të caktuara për diversifikim eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave të Fizioterapisë, Tabela 24;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimet me drejtuesitë e njësisë bazë dhe kryesore.</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë	GVJ konstaton se UAL garanton qëndrueshmërinë ekonomike në forma të ndryshme. Nga mirëadministrimi i të ardhurave,




<p>financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>mungesa e detyrimeve ndaj të tretëve, individë, organizata, banka apo organe tatimore, hartimi i planeve të detajuara financiare, investime në infrastrukturën mësimore etj. Reflektimi i qëndrueshmërisë financiare të UAL është edhe rritja e numrit të punonjësve, laboratorëve në funksion të mësimdhënies, numri i studentëve që ndjekin programin e studimit BSc. Fizioterapi dhe qëndrueshmëria e treguesve makroekonomik të institucionit edhe në kohë krizash.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>23. Tabelat e të dhënave të Fizioterapisë, Tabela 24;</p> <p>13.1. Relacion infrastrukture;</p> <p>Vizita në institucion, takimet me drejtuesitë e njësisë bazë dhe kryesore.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAL garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit BSc. Fizioterapi dhe mbështetjen e studentëve. Kjo sigurohet në sajë të planifikimit dhe auditit vjetor financiar që fillon në nivel të njësisë bazë. Raportet financiar të auditimit të brendshëm u vihen në dispozicion anëtarëve të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Në bazë të problematikave të evidentuara, institucioni me anë të Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik kryen diversifikimin eventual të shpenzimeve në funksion të mbarëvajtjes dhe sigurimit të qëndrueshmërisë të cilësisë së programit të studimit dhe gjithë procesit mësimor. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1




**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UAL ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të programit BSc. Fizioterapi nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Këto politika përfshijnë caktimin e koordinatorit mësimor të programit të studimit që shërben si urë lidhëse midis stafit akademik dhe studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve. Caktimi i tutorit akademik i çdo grupi mësimor që i ndjek ata që nga momenti i pranimi deri në diplomim është një shembull tjetër i procedurave mbështetëse të studentëve gjatë gjithë periudhës së studimit. Në bazë të planit mësimor hartohet edhe shpërndarja e elementeve të mësimdhënies si leksione, seminare, praktika duke përcaktuar kushtet dhe mundësitë për kryerjen me sukses të tyre nga ana e studentëve.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.9. Rregullore e Tutoriatit Akademik;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimet stafin akademik, studentwt dhe drejtuesitë e njësisë bazë dhe kryesore.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Ky program studimi është hartuar dhe zbatohet duke marrë parasysh lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe të studentëve bazuar në legjislacionin në fuqi. Si i tillë, ai garanton të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët që aplikojnë në UAL si dhe për studentët e këtij program studimi. Të drejtat dhe detyrat e studentëve parashikohen në Statutin dhe Rregulloren e universitetit, si dhe në Rregulloren e këtij programi studimi.</p> <p>Procedurat dhe politikat e ndjekura nga hyrja në dalje nga UAL garantojnë barazinë si për kandidatët e interesuar për të ndjekur një program studimi ashtu edhe për studentët që ndjekin programin e studimit. Kuotat dhe kriteret e pranimi miratohen sipas procedurave ligjore dhe ato janë të shpallura publikisht e janë të aksesueshme nga të gjithë. Informacioni publikohet edhe në faqen zyrtare të UAL-së. Të gjithë kandidatët fitues duhet të dorëzojnë personalisht ose me prokurë nga ana e tyre dokumentacionin e nevojshëm (fotokopje të dokumentit të identifikimit, fotokopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore, certifikatë notash, cdo diplomë tjetër të fituar</p>



	<p>brenda vendit, diplomë jashtë vendit të njehësuar në QSHA, deklaratën e plotësuar nga aplikuesi në prani të sekretares) për regjistrim në programin e studimit që kanë përzgjedhur dhe janë shpallur fitues. Zyra e Sekretarisë Mësimore mban regjistër të vecantë për dorëzimin e dokumentacionit të aplikantëve fitues që regjistrohen në programin e studimit. Sekretaria mësimore kryen regjistrimin online të aplikantëve fitues në portalin U-Albania. Në fund të procedurës firmoset nga sekretarja dhe aplikanti në dy kopje formulari i shkarkuar nga sistemi, ku një kopje i dorëzohet aplikantit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>6. Kontratë studenti (model);</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimet me studentët dhe përfaqësues të Zyrës së Sekretarisë Mësimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>UAL harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Kriteret e pranimit përcaktohen me vendim senati dhe në mbështetje të kriterëve kombëtare për IAL-të. Kriteret shpallen publikisht në U-Albania dhe u bëhen të ditura të gjithë kandidatëve të interesuar edhe gjatë periudhës së informimit. UAL në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse bashkëpunon gjatë gjithë periudhës së aplikimeve në kohë reale me QSHA. Kriteret parashikojnë edhe planifikimin e kuotave të pranimit për studentët nga trojet. Për programin BSc. Fizioterapi i cili ofrohet vetëm në gjuhën shqipe nuk u raportua asnjë rast regjistrimi i studentëve të huaj.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>1. Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>3.1. Rregullore e Universitetit;</i></p> <p><i>3.2. Rregullore e FSHMT;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimet me studentët, përfaqësues të Zyrës së Sekretarisë Mësimore, drejtuesin e njësisë bazë.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së</p>	<p>Në UAL Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku, përfshirë dhe studentët e programit BSc. Fizioterapi. Kushtet dhe procedura e transferimit të studimeve të aplikantëve janë të</p>




<p>studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>përcaktuara në udhëzimin e përvitshëm dhe u bëhen të ditura edhe nga koordinatori i programit. Për njohjen e krediteve ngrihet një komision ad-hoc që shqyrton dokumentacionin e dorëzuar dhe del me një vendim, ku një kopje e vendimit i jepet kandidatit dhe një kopje është pjesë e dokumentave të regjistrimit të depozituara në institucion.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>6.2. Procedura e transferimit të krediteve;</i></p> <p><i>1. Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>3.1. Rregullore e Universitetit;</i></p> <p><i>3.2. Rregullore e FSHMT;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesin e njësisë bazë.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>UAL përpara fillimit të çdo viti akademik, informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit BSc. Fizioterapi nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme. Këto aktivitete koordinohen nga Zyra e Informimit dhe Njësitë akademike dhe përfshijnë fushata informimi, pjesëmarrjen në Panairin Work and Study të organizuar në Tiranë dhe rrethe sipas afateve të përcaktuara nga MAS dhe një kalendari të shpallur paraprakisht. Institucioni është gjithashtu në dispozicion të të gjithë të interesuarve gjatë gjithë vitit për informacion në lidhje me ofertën akademike që UAL ofron. Informacion i detajuar në lidhje me ofertën akademike, kriteret etj., është i disponueshëm dhe aksesueshëm publikisht nga të gjithë të interesuarit edhe në faqen zyrtare web të UAL, katalogun e universitetit, adresa postare, e-maili zyrtar I institucionit, numra telefoni në dispozicion dhe rrjetet e komunikimit social si Facebook etj.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Katalogu-Aldent-OK3-2.</i></p> <p><i><a href="https://www.ual.edu.al/ual.edu.al/wp-content/uploads/2017/04/Katalogu-Aldent-OK3-2-shqip.pdf">https://www.ual.edu.al/ual.edu.al/wp-content/uploads/2017/04/Katalogu-Aldent-OK3-2-shqip.pdf</a>;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesin e njësisë bazë dhe përfaqësues të Zyrës së Informimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e</p>	<p>Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara të interesuar për programin e studimit BSc. Fizioterapi hartohen dhe publikohen përpara fillimit të çdo viti akademik nga UAL. Institucioni</p>




<p>kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>ndjek politika të barabarta pranimi për të gjithë studentët pavarësisht nëse janë pjesë e shtresave të marginalizuara apo me aftësi të veçanta. Infrastruktura e UAL është reflektimi i kësaj qasje, e cila përmbush të gjitha standardet dhe normativën e kërkuar për personat me aftësi ndryshe.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>13. Planimetria e kampusit;</i></p> <p><i>13.1. Relacion infrastrukture;</i></p> <p><i>Vizita në institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>UAL ka hartuar dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera kryesisht shtetas të huaj që zotërojnë gjuhën shqipe nga trojet. Ata informohen në lidhje me njehësimin e diplomës së shkollës së mesme, plotësimin e detyrimeve ligjore dhe nevoja të tjera që lidhen me qëndrimin e tyre në Shqipëri gjatë periudhës së studimit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës së Informimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UAL ka politika të qarta mbështetëse të ndihmës/bursave për studentët që i përkasin shtresave në nevojë si studentët romë, ballkano-egjiptian por edhe për studentët me performancë të lartë akademike me ndikim real në rritjen e cilësisë së programit të studimit. Këto politika janë të reflektuara në kontratat individuale të studentëve pas depozitimit të kërkesës dhe dokumentacionit për mbështetje financiare në njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit BSc. Fizioterapi.</p> <p>Disa shembuj të mbështetjes financiare përfshijnë mbajtjen të pandryshuar të tarifës vjetore të studimit pavarësisht inflacionit në vend apo 10% zbritje nga tarifa e plotë vjetore e studimit nëse paguhet tarifa e plotë në 3 muajt e parë të vitit akademik, studentët që janë nga e njëjta familje, studentët që janë fëmijë të stafit akademik apo administrativ të UAL, studentët që përsërisin një vit akademik etj. Nga kjo klauzolë përfitojnë çdo vit rreth 75% e studentëve të UAL. Mbështetje financiare mundësohet edhe për stafin akademik që kryen specializim apo master për rritje profesionale në masën 50% të tarifës vjetore.</p>




	<b>Evidenca:</b> 6.1. Politikat e mbështetjes së studentëve; 6.2. Procedura e transferimit të krediteve; Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin.			
<b>Konkluzione</b>	UAL harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit BSc. Fizioterapi. Këto politika dhe procedura janë publike dhe të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit edhe në faqen zyrtare web të institucionit. UAL ka edhe politika të qarta mbështetëse të ndihmës/bursave për studentët që i përkasin shtresave në nevojë dhe studentëve me performancë të lartë akademike apo kategori të tjera të vecanta. Këto politika janë të pasqyruara në kontratat individuale të studentëve pas depozitimit të kërkesës dhe dokumentacionit për mbështetje financiare në njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit BSc. Fizioterapi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Informacioni i plotë dhe i hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, studentëve që ndjekin programin e studimit BSc. Fizioterapi u mundësohet nga përgjegjësi i programit. Informacioni përfshin njohjen me rregulloren e programit të studimit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijeve, konvertimin e pikëve në notë, pikëzimin e elementëve të shumfishtë, notën kaluese etj. Informacioni mundësohet edhe nga lektorët e lëndës në orën e parë të zhvillimit të lëndës.</p> <p><b>Evidenca:</b> 17. Rregullore e programit BSc në Fizioterapi; Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin.</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UAL ka procedura të miratuara në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme të studentëve të interesuar të cilëve u vihet në dispozicion informacioni i nevojshëm ër procesin. Për realizimin e këtij procesi, ngrihet nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike një komision ad-hoc, Komisioni i Ekuivalentimit i cili ekuivalenton dhe njeh kreditet e fituara nga kandidati në studime të mëparshme të kryera prej tij.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>6.2. Procedura e njohjes dhe transferimit të krediteve;</i>  <i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>UAL informon studentët e programit BSc. Fizioterapi në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre. Informacioni është i detajuar në syllabusin e çdo lënde të programit të studimit dhe studentët e marrin këtë informacion nga pedagogu përkatës në ditën e parë të mësimin të çdo moduli. Ngarkesa dhe karakteristikat e modulit janë dy elementë të cilët merren parasysh në pikëzimin e elementëve të veçantë të lëndëve të çdo programi studimi.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>27. Syllabuset e moduleve;</i>  <i>Vizita në institucion, takimi stafin akademik dhe studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Për informimin e studentëve në lidhje me kriteret e procedurat e e diplomimit në programin e studimit BSc. Fizioterapi, UAL ka caktuar Përgjegjësin e programit. Përgjegjësi i programit informon studentët për procedurën në fillim të procesit të studimeve. Për programin BSc.Fizoterapi, diplomimi i studentëve nuk parashikon mbrojtje diplome me temë edhe pse aktet rregullatore të UAL parashikojnë dy mënyra për mbrojtjen e diplomës, me temë diplome dhe provim përfundimtar. Studentët në prag diplomimi marrin informacion edhe për karakteristikat e provimit përfundimtar, i cili është një test përmbledhës i njohurive që studenti ka marrë gjatë tre viteve akademike të kohëzgjatjes së programit të studimit BSc. Fizoterapi.</p> <p><b>Evidenca:</b></p>




	<p>17. Rregullore e programit BSc në Fizioterapi; 22. Raport i koordinatorit të programit model; Vizita në institucion, takimi me studentët dhe përgjegjës in e programit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>UAL përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike informon kandidatët e interesuar mbi programin e studimit BSc. Fizioterapi nëpërmjet organizimit të takimeve të hapura për informim dhe publikimit të udhëzuesve të posaçëm sic janë katalogët e shkollës, fletët informuese dhe faqes zyrtare web të institucionit. Sekretaria mësimore, përgjegjësi i programit të studimit dhe stafi akademik i angazhuar në programin e studimit janë pjesë aktive e procesit të informimit të studentëve, vecanërisht në muajin shtator kur dhe zhvillohet periudha e informimit. Gjithashtu, periudha e regjistrimeve dhe hapësira kohore midis raundeve konsiderohen nga UAL si ditë të hapura për informim.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Katalogu-Aldent-OK3-2.</i> <i><a href="https://www.ual.edu.al/ual.edu.al/wp-content/uploads/2017/04/Katalogu-Aldent-OK3-2-shqip.pdf">https://www.ual.edu.al/ual.edu.al/wp-content/uploads/2017/04/Katalogu-Aldent-OK3-2-shqip.pdf</a>;</i> <i>Vizita në institucion, takimi me përgjegjës in e programit, stafin akademik, studentët.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAL vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit BSc. Fizioterapi, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit. Ky informacion është i disponueshëm në syllabuset e çdo lënde të modulit dhe u bëhet i ditur studentëve nga pedagogu i cdo lënde dhe përgjegjësi i programit. Ekuivalentimi dhe transferimi i krediteve të studimeve të mëparshme kryhet në bazë të një procedure të përcaktuar dhe miratuar. UAL informon kandidatët e interesuar për programin e studimit nëpërmjet ditëve të informimit që organizon, faqes zyrtare web të institucionit, dhe udhëzues të posaçëm si katalogë, fletë informuese etj.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi V.3**




**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Studentët e programit BSc. Fizioterapi informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit nga përgjegjësi i programit. Informacioni i detajuar përfshin mënyrën e organizimit të procesit mësimor, kalendarin akademik, periudhat e teorisë dhe praktikës, sesionet e provimeve, periudhën e zhvillimit të provimit të përfundimtar etj. Informacion i nevojshëm disponohet edhe në rregulloren e programit dhe rregulloren e praktikave mësimore.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i></p> <p><i>18. Rregullore e praktikave;</i></p> <p><i>22. Raport i koordinatorit të programit model;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me përgjegjësin e programit dhe studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>UAL vë në dispozicion të studentëve informacion, dokumentacion e udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit BSc. Fizioterapi. Katalogu-Aldent është një nga udhëzuesit informues, ndërkohë që studentët informohen edhe nëpërmjet përgjegjësit të programit, tutori akademik, dhe tabelat informuese që gjenden në auditorin e leksioneve. Në platformën UALe-Learning është detyrim akademik që të publikohet çdo informacion që ka lidhje me modulet e programit të studimit në klasën përkatëse të modulit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>7. Manual FxEducation;</i></p> <p><i>Katalogu-Aldent-OK3-2.</i></p> <p><i><a href="https://www.ual.edu.al/ual.edu.al/wp-content/uploads/2017/04/Katalogu-Aldent-OK3-2-shqip.pdf">https://www.ual.edu.al/ual.edu.al/wp-content/uploads/2017/04/Katalogu-Aldent-OK3-2-shqip.pdf</a>;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me përgjegjësin e programit, stafin akademik dhe studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi</p>	<p>UAL ka ngritur njësi të caktuara, si Zyra e Informimit dhe Zhvillimit të Karrierës për të informuar studentët e programit</p>




<p>mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>të studimit BSc. Fizioterapi në lidhje me mundësitë e punësimit dhe zhvillimin e karrierës. Kjo zyrë mbështet studentët që diplomohen dhe të diplomuarit për tu orientuar dhe integruar në tregun e punës. Kjo zyrë mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, merret me gjurmimin e tyre si dhe i bën pjesë të akativiteteve të edukimit në vazhdim që UAL organizon.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.8. Rregullore e Zyrës së Karrierës;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të Zyrës së Informimit dhe Zhvillimit të Karrierës.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>UAL informon studentët me informacion të vazhdueshëm dhe të përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Platforma e-Learning është në dispozicion të procesit akademik që nga periudha e pandemisë dhe është funksionale dhe aksesohet lirisht nga studentët dhe stafi akademik i UAL. Studentët e fizioterapisë gjatë periudhës së pandemisë kanë ofruar vullnetarisht edhe shërbime dhe asistencë fizioterapeutike në institucione shëndetësore publike.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>22. Raport i koordinatorit të programit model;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me përgjegjës të programit, studentët dhe drejtuesin e njësisë bazë.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit, platforma FxEducation në UAL mundëson informimin e të gjithë studentëve të programit BSc. Fizioterapi në çdo kohë dhe çdo vend. Nëpërmjet llogarisë së tyre individuale dhe emailit institucional studentët mund të aksesojnë në platformë dhe të marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me performancën e tyre akademike. Aksesimi në platformë mundësohet nëpërmjet faqes zyrtare web të UAL <a href="https://ual.edu.al/ual.edu.al/">https://ual.edu.al/ual.edu.al/</a> në rubrikën portal i studentit <a href="https://portalonline.ual.edu.al/">https://portalonline.ual.edu.al/</a>.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>7. Manual FxEducation;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, konsultimi i faqes zyrtare web të UAL.</i></p>






<b>Konkluzione</b>	<i>UAL nëpërmjet njërive të caktuara të ngritura, personat përgjegës të caktuar për programin e studimit, akteve rregullatore të brendshme të programit të studimit dhe institucionit, sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit që disponon, platformës FxEducation, aktiviteteve të informimit që organizon, udhëzuesve dhe faqes zyrtare web u vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit BSc. Fizioterapi informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>UAL nëpërmjet strukturave të tij, disponon dhe administron statistika vjetore mbi numrin e studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi si dhe atyre që janë diplomuar. Administrimi i të dhënave në regjistrat përkatës realizohet në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera nënligjore. Përgjegjëse për administrimin e të dhënave është Sekretaria Mësimore, e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> <p>Në kuadrin e detyrave të saj për hedhjen dhe administrimin e të dhënave lidhur me studentët që ndjekin këtë program studimi, Sekretaria Mësimore administron një regjistër të veçantë, regjistrin e të diplomuarve. Ky regjistër përmban të dhënat e studentëve që kanë përfunduar me sukses programin e studimit dhe janë diplomuar sipas programeve të studimit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave për programin e studimit, Tabela 15, studentët;</i></p> <p><i>3.4. Rregullore e Sekretarisë;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të Sekretarisë Mësimore.</i></p>

**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

UAL disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit BSc. Fizioterapi, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Ky informacion ruhet dhe menaxhohet nga Sekretaria Mësimore në formatin digjital nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe formatin fizik në dosjen e secilit student në sekretari. Në funksion të këtij kriteri UAL disponon informacionin në regjistrat fizikë dhe elektronikë. Nga statistikat e disponueshme evidentohet se në tre vitet e kaluara nuk ka asnjë të transferuar apo të larguar nga programi i studimit. Nga vëzhgimi i GVJ pranë Sekretarisë Mësimore u konstatua administrimi në mënyrë të rregullt i të dhënave të studentëve për të gjithë ciklin akademik. Nga të dhënat e institucionit evidentohet si vijon:

Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të cregjistruarve	Nr aktual
2021-2022	55	6	49
2022-2023	34	3	31
2023-2024	29	0	29
<b>Totali</b>	<b>109</b>		

**Evidenca**

23. Tabelat e të dhënave për programin e studimit, Tabela 15, studentët;

3.4. Rregullore e Sekretarisë;

Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të Sekretarisë Mësimore.

**Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit në UAL, FxEducation është i sigurtë dhe lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar. Informacioni për arritjet akademike të studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve të studimit disponohet elektronikisht dhe fizikisht në zyrën e Sekretarisë Mësimore. Hedhja dhe modifikimi i informacionit në sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit kryhet nga persona të autorizuar në varësi të detyrës si sekretaria, dega mësimore, apo tutori akademik.

	<p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>7. Manual FxEducation;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të Sekretarisë Mësimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>UAL kryen kontrollin periodik të përvitshëm për menaxhimin pranë gjithë njësive përgjegjëse si sekretaria mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit etj. Kontrolli periodik synon vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët e çdo programi studimi dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. Ky kontroll dhe monitorim periodik kryhet nga Administratori i institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.4. Rregullore e Sekretarisë;</i></p> <p><i>3.7. Rregullore e Burimeve Njerëzore.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit BSc. Fizioterapi, konkretisht Departamenti i Infermierisë e Fizioterapisë, harton raporte analitike dhe periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre. Këto raporte janë pjesë e raportit vjetor institucional. Në bazë të analizës dhe gjendjes egzistuese të cilësisë së programit të studimit sugjerohen masa për përmirësim.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>Analiza e gjurmimit të studentëve për vitin akademik 2018-2023;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesitë e njësisë bazë dhe kryesore.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAL mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit BSc. Fizioterapi, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Informacini ruhet në formatin digjital dhe fizik dhe menaxhohet nga njësi të caktuara që institucioni ka ngritur si zyra e Sekretarisë Mësimore, Sistemi i brendshëm i menaxhimit</i></p>





	<i>të informacionit, platforma FxEducation, Zyra e Këshillimit të karrierës dhe ALUMNI etj.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>UAL bazuar në aktet ligjore për arsimin e lartë, statutin dhe rregulloret e institucionit parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. Shembulli i kësaj përfshirje është edhe përfaqësuesi i studentëve në grupet e punës dhe procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimeve dhe akreditimit institucional.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>1. Statuti i Universitetit Aldent;</i>  <i>3.1. Rregullore e Universitetit;</i>  <i>3.2. Rregullore e FSHMT;</i>  <i>3.5. Rregullore e Senatit studentor;</i>  <i>Vizita në institucion, takimi me GVB.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UAL garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim periodik të programeve të studimit dhe institucionit. Përfshirja e studentëve në këto procese është reale dhe konkrete pasi cdo grup mësimor përfaqësohet nga një senator që është anëtar i Senatit të asamblesë studentore. Kjo asamble mbledhet periodikisht dhe përcjell problematika apo kërkesa të studentëve në organet ku ata janë pjesë. Studentët nëpërmjet organizimit të pyetësorëve janë pjesë aktive edhe e vlerësimit akademik me impakt të drejtpërdrejtë në cilësinë e mësimdhënies dhe programit të studimit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p>




	<p><i>1. Statuti i Universitetit Aldent;</i>  <i>3.1. Rregullore e Universitetit;</i>  <i>3.5. Rregullore e Senatit studentor;</i>  <i>Vizita në institucion, takimi me GVB dhe studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Departamenti i Infermierisë e Fizioterapisë në UAL, përgjegës për programin e studimit BSc. Fizioterapi garanton përfshirjen e rregullt të studentëve në procese të rëndësishme akademike si procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit etj. Studentët janë pjesë e komisioneve dhe grupeve të punës në këto procese si komisioni i NJSBC, komisioni i kurrikulave, GVB, komisioni i kërkimit shkencor etj. Kontributi dhe sugjerimet e tyre janë pjesë e raporteve të hartuara nga komisionet ku ata janë pjesëmarrës.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.1. Rregullore e Universitetit;</i>  <i>3.2. Rregullore e FSHMT;</i>  <i>3.3. Rregullore e NJSBC;</i>  <i>3.5. Rregullore e Senatit studentor;</i>  <i>Vizita në institucion, takimi me GVB dhe studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët në UAL kanë të drejtën e dhënies së mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Këto të drejta janë të përshkruara në dokumentat rregullatorë të institucionit dhe respektohen me rigorozitet nga stafi akademik, ndihmës akademik, administrativ, sekretaria mësimore dhe organet drejtuese të institucionit. Studentë që ndjekin programin e studimit BSc. Fizioterapi kanë mundësinë e rishikimit të rezultatit të provimeve dhe reflektimit nga ana e pedagogut përkatës dhe ankimimit të rezultatit nëse konsiderohet e nevojshme.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>17. Rregullore e programit Ba në Fizioterapi;</i>  <i>3.6. Rregullore provimi.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAL përfshin dhe angazhon konkretisht the aktivisht studentët, përfshirë dhe studentët e programit BSc. Fizioterapi në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Studentët janë pjesë e komisioneve të caktuara si GVB, komisioni i kurrikulave, komisioni i NJSBC etj. Studentët kanë</i></p>

	<i>të drejtën e dhënies së mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve të tyre dhe të ankimimit të rezultatit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Zyra e informimit dhe Zhvillimit të Karrierës në UAL është njësia e posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Kjo zyrë në bashkëpunim me njësitë të tjera të UAL informon kandidatët e interesuar në lidhje me programin e studimit BSc. Fizoterapi, kriteret e pranimit, avantazhet profesionale që programi ofron, informimin dhe këshillimin e studentëve në momentin e rregjistrimit dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me studimet.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.8. Rregullore e Zyrës së Karrierës;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të Zyrës së Karrierës.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Në UAL është ngritur dhe funksionon Shërbimi i Tutoriatit, një sistem i posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimin e studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit BSc. Fizoterapi. Në veprimtarinë e tutoriatit është i përfshirë i gjithë personeli akademik i anagazhuar në programin e studimit. Mbi bazën e akordeve paraprake midis studentëve dhe stafit akademik të angazhuar në programin e studimit përcaktohet dhe tërësia e veprimtarive dhe angazhimeve të tutorëve me studentët në nivel individual apo grupi. Shërbimi i Tutoriatit luan një rol të vecantë në parandalimin e largimeve apo zgjatjes së periudhës së studimeve nga ana e studentëve</p>




	<p>duke i mbështetur në problematikat e hasura dhe nxitur ata vazhdimisht për të qënë pjesë aktive e jetës universitare</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.9. Rregullore e Tutoriatit Akademik.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Shërbimi dhe këshillimi i karrierës për studentët në UAL ofrohet në mënyrë të vazhduar dhe periodike nga Zyra e Informimit dhe Këshillimit të Karrierës. Në përmbushje të këtij kriteri, kjo zyrë organizon aktivitete me fokus dhe tematika të ndryshme të cilat ofrojnë informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale, orientimin në tregun e punës dhe punësimin, menaxhimin e stresit gjatë periudhës së studimeve, metodat efektive të mësimdhënies, hartimin e CV-së, përgatitjen për një intervistë pune, pjesëmarrja në panairët e punës etj.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.8. Rregullore e Zyrës së Karrierës;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të Zyrës së Karrierës.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimin të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Informimit dhe Këshillimit të Karrierës ndjek studentët edhe pas diplomimit të tyre. Studentët në prag diplomimi dhe Alumni informohen nëpërmjet aktiviteteve të dedikuara si këshillimi individual i karrierës apo organizimi i tryezave të rrumbullakta, seminareve e konferencave ku janë edhe të ftuar. UAL ka krijuar dhe një bazë të dhënash, e cila dokumenton punësimin e studentëve të diplomuar, ruajtjen e kontakteve, dhe mundësinë e përfshirjes për punësim në sajë të njoftimeve për vende vakante pune në institucione të ndryshme shëndetësore publike dhe private. Në funksion të bazës së të dhënave dhe gjurmimit të studentëve të diplomuar shërben edhe faqja në rrjetet sociale <a href="https://www.facebook.com/universitetialdent">https://www.facebook.com/universitetialdent</a> e emërtur Alumni Aldent.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.8. Rregullore e Zyrës së Karrierës;</i></p> <p><i>Analiza e gjurmimit të studentëve për vitin akademik 2018-2023;</i></p>




	<i>Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të Zyrës së Karrierës.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>UAL ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve të programit Bsc. Fizioterapi, menaxhimin e ankimeve e problematikave. Zyra e Informimit dhe Këshillimit të Karrierës është njësi përgjegjëse për këtë proces. Kjo zyrë në bashkëpunim me njësi të tjera të institucionit zhvillojnë veprimtari të vazhdueshme të cilat janë lehtësisht të arritshme për studentët që ndjekin programet e studimit por edhe për studentët e diplomuar, Alumni Aldent.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</b>	UAL në vizionin dhe politikat e veta të zhvillimit ka në fokus përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe integrimin e përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies bazuar në karakteristikat e programit dhe specifikat e lëndëve. Reflektim i këtyre politikave është infrastruktura bashkëkohore, auditorët e mësimdhënies të pajisura me videoprojektor, internet dhe pajisje të tjera teknologjike didaktikore. Inkurajimi dhe mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrje në mobilitete për shkëmbim të praktikave të mira, organizimi i leksioneve të hapura me lektorë të huaj etj, janë shembuj të tjerë të këtyre politikave. Edhe pse gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik të angazhuar në programin e studimit BSc. Fizioterapi u evidentua përdorimi i metodave interaktive dhe inovative të



	<p>mësimdhënies si studimi i rasteve, <i>GVJ konstaton se institucioni nuk disponon udhëzues të vecantë që lidhen specifikisht me metodat të ndryshme innovative të mësimdhënies, si edukimi simulator, imersiv etj.</i></p> <p><i>Për këtë, GVJ rekomandon hartimin e këtij udhëzuesi duke marrë për bazë edhe përvojën nga shkëmbimet e stafit, lektorët e ftuar dhe praktikant në këtë drejtim të institucioneve partnere me të cilët UAL bashkëpunon.</i></p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>1. Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>2. Strategjia i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>3.2. Rregullore e FSHMT;</i></p> <p><i>10. Të dhëna mbi mobilitetet;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin akademik.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik të angazhuar në programin e studimit BSc, Fizioterapi vlerësohen në mënyrë periodike nga strukturat përgjegjëse të UAL. Këto struktura përfshijnë NJSBC, e cila organizon pyetësorin e studentëve për vlerësimin ndër të tjera edhe të procesit të mësimdhënies, njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit, konkretisht Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë nëpërmjet përditësimit të kurrikulës, koordinatorit të programit të studimit për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe adresimin e çdo problematike të hasur, tutoriati akademik etj. Gjithashtu, stafi akademik dhe ndihmësakademik i angazhuar në programin e studimit përditëson dosjen e vetë dhe CV-në me arritjet profesionale si akademike dhe kërkimore shkencore. Dosja e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Çdo anëtar i stafit akademik ka detyrimin vjetor të plotësimit të formularit të performances, i cili dorëzohet te drejtuesi i departamentit përkatës.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>4.1. Formulari i performancës akademike;</i></p> <p><i>16. Rregullore e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi dhe stafin akademik, drejtuesin e njësisë bazë, përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Burimeve Njerëzore.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e</p>	<p>Studentët në UAL janë pjesë aktive e vlerësimit periodik të formave e metodave të mësimdhënies. Garantimi i përfshirjes</p>




<p>studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>së studentëve në këtë proces mundësohet nëpërmjet inkorporimit të këtyre mekanizmave në aktet e brendshme rregullatore të institucionit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Shembull konkret i këtij procesi është pyetëtori i studentit i cili aplikohet çdo vit nga NJSBC.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>1. Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>3.2. Rregullore e FSHMT;</i></p> <p><i>3.3. Rregullore e NJSBC;</i></p> <p><i>11. Pyetësorët e studentëve-model;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi dhe studentët, drejtuesin e njësisë bazë, dhe përfaqësues të NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC, struktura përgjegjëse në UAL për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie për programin e studimit BSc. Fizoterapi pas aplikimit të pyetësorit të studentëve analizon të dhënat dhe i përmbledh ato në një raport. Ky raport është vjetor, publik dhe përfshin edhe planin e masave të propozuara për përmirësimin e treguesve me performancë të ulët. UAL për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies angazhohen në mënyrë periodike edhe grupet e auditimit të brendshëm, të cilat hartojnë një raport që i përcillet titullarit të institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>8. Raporti i NJSBC;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi drejtuesin e njësisë bazë dhe kryesore.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Promovimi i shembujve të praktikave të mira, nxitja e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies si rezultate të vlerësimit periodik janë pjesë integrale e planit strategjik zhvillimor të UAL. Stafi akademik, ndihmëskademiq administrativ dhe studentët janë pjesë integrale dhe pjesëmarrës aktiv në këtë proces me angazhim maksimal në në sigurimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>2. Strategjia e institucionit;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimet me stafin akademik dhe studentët.</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<i>UAL ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies për programin e studimit BSc. Fizioterapi. Garantimi mundësohet nga njësi të vecanta të ngritura dhe mekanizma të mirëpërcaktuar. Stafit akademik, ndihmëskademiq administrativ dhe studentët janë pjesë integrale dhe pjesëmarrës aktiv në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. UAL nëpërmjet investimeve në infrastrukturën, logjistikën e mësimdhënies dhe mbështetjen e stafit për mobilitete dëshmon gadishmëri maksimale për hartimin dhe zbatimin e udhëzuesve të posaçëm të zhvillimit dhe monitorimit të metodave inovative të mësimdhënies.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>UAL në përputhje me legjislacionin ligjor në fuqi dhe aktet rregullatore institucionale ka hartuar politika, ngritur struktura dhe zbaton procedura për SBC. NJSBC është njësi përgjegjëse e sigurimit të brendshëm të cilësisë e cila është ngritur në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe statutin e institucionit. Kjo njësi ka rregulloren e saj të funksionimit dhe koordinon, monitoron dhe zbaton çdo veprimtari që lidhet me sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, mësimnxënies, infrastrukturën, burimet dhe rezultatet e studentëve.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.3. Rregullore e NJSBC;</i></p> <p><i>8. Raport i NJSBC;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimet me përfaqësues të NJSBC.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një	Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në UAL koordinohet nga NJSBC në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha njësitë dhe strukturat e tjera të institucionit. Ky proces është funksional dhe ushtrohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë, Statutin dhe Rregulloren e UAL dhe




<p>strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Standardet shtetërore dhe udhëzimet për vlerësimin e jashtëm nga ASCAL. NJSBC në procesin e sigurimit të cilësisë bashkëpunon edhe me aktorë të jashtëm, si Instituti për Cilësi në Arsim me të cilin institucioni ka bashkëpunim të gjatë në anketimin e studentëve dhe stafit. Auditimi i përvitshëm i institucionit për plotësimin e standardeve dhe infrastrukturës nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve luan gjithashtu rol të rëndësishëm në këtë proces. Studentët janë pjesë aktive e procesit me përfaqësinë e tyre dhe kryerjen e pyetësorit të studentit nga NJSBC. Raporti i hartuar në përfundim të procesit nga NJSBC shërben për të adresuar problematikat e hasura në çdo nivel.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.3. Rregullore e NJSBC;</i></p> <p><i>8. Raport i NJSBC;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimet me përfaqësues të NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UAL përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Në kuadër të këtij kriteri, në përputhje me detyrimet ligjore, UAL i është nënshtruar periodikisht akreditimeve me ekspertë vendas dhe të huaj të aprovuara nga ASCAL. Shembull i kësaj praktike është dhe akreditimi periodik i programit të studimit BSc. Fizioterapi. Bazuar në konstatimet dhe gjetjet e proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, NJSBC harton raporte periodike dhe raportin vjetor i cili është transparent, publik dhe i aksesueshëm nga stafi, studentët dhe gjithë palët e interesuara.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>15. Vba.36, 13.07.2018;</i></p> <p><i>Shkrese përcjellëse për RVB;</i></p> <p><i>Evidenca 8. Raport i NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve</p>	<p>UAL mbështetur në hierarki funksionale dhe mbikëqyrse mban nën kontroll të vazhdueshëm tregues të qartë, të matshëm për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Zbatimi i programit mësimor dhe i treguesve si cilësor dhe sasior të tij si numri i studentëve të regjistruar, performanca e tyre akademike, cilësia e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit etj, koordinohen nga Dekani, drejtuesi i departamentit, përgjegjësi i programit të</p>




cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.	<p>studimit BSc. Fizioterapi dhe përfaqësuesi i NJSBC në fakultet. Stafi akademik është i informuar për procesin dhe është pjesë aktive e tij. Modelet e mira promovohen dhe mbështeten nga institucioni në forma të ndryshme.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>22. Raport i koordinatorit të programit model; Vizita në institucion.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>UAL harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit BSc.Fizioterapi, në kuadër të ngritjes dhe funksionimit të NJSBC, strukturës së sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Kjo strukturë në bashkëpunim të ngushtë me njësitë e tjera të institucionit, ekspertë të jashtëm dhe pjesëmarrjen aktive të stafit dhe studentëve koordinon dhe monitoron procesin e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë në nivel programi dhe institucioni. NJSBC në kuadër të procesit harton një raport i cili është pjesë e raportit vjetor të institucionit, publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e</p>	<p>Raporti vjetor i hartuar i NJSBC në kuadër të veprimtarive të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë është pjesë e raportit vjetor institucional. Ky raport dokumentohet dhe i vihet në dispozicion rektoratit të UAL. Institucioni kryen dhe analizën vjetore e cila është gjithëpërfshirëse në nivel njësie bazë, kryesore dhe programi studimi. Raporti vjetor institucional në përputhje me legjislacionin në fuqi dërgohet edhe në MAS. Edhe procesi i pyetësorit të studentëve koordinohet nga NJSBC në bashkëpunim me Institutin për Cilësi në Arsim. Edhe auditimi i përvitshëm i MAS për cilësinë e stafit akademik dhe infrastrukturën përmbledhet dhe dokumentohet raportin e NJSBC. Rezultatet e vlerësimeve</p>




<p>praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>dokumentohen në raportin e NJSBC dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse të çdo niveli për programin e studimit BSc.Fizioterapi.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>11. Pyetësorët e studentëve-model;</i></p> <p><i>8. Raport i NJSBC;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesin e njësisë bazë, kryesore dhe përfaqësues të NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit të cilësisë të NJSBC, përfshijnë rezultatet e vlerësimit të pyetësorëve të paraqitura me përqindje dhe grafik për çdo pyetje. Në raport është e paraqitur dhe analiza e gjetjeve e cila shërben për hartimin e planit të masave për adresim të mangësive dhe promovim të arritjeve më të mira akademike, kërkimore shkencore për stafin dhe studentët.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>11. Pyetësorët e studentëve-model;</i></p> <p><i>8. Raport i NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i</p>	<p>UAL në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit BSc. Fizioterapi përdor, metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Shembuj të metodave të vlerësimit përfshijnë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet aplikimit vjetor të pyetësorit të studentëve, diskutimeve të hapura me studentët, vlerësimin e procesit të të mësuarit etj.</p> <p>Referuar RVB-së, metodat e tërthorta përfshijnë rezultatet e arritura nga provimi (Vlerësimi i Arritjeve Praktike) dhe provimi teorik nga QSHA për licensimin e studentëve dhe informacioni i vashdueshëm me UISH, gjurmimin e Alumni etj. Studentët vlerësohen edhe për praktikën profesionale nga mbikëqyrësi i praktikës në mjediset klinike për etikën, performancën dhe aftësitë e tyre praktike.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>11. Pyetësorët e studentëve-model;</i></p>

shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<p>8. Raport i NJSBC; 18. Rregullore e praktikave; Analiza e gjurmimit të studentëve për vitin akademik 2018-2023.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>UAL, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit BSc. Fizioterapi përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si pyetësorin e studentëve, gjurmimin dhe bazën e të dhënave të Alumni, intervistave të studentëve nga Sistemi i Tutoriatit-Kujdestarëve të Grupeve të studentëve, vlerësimi nga mbikëqyrësit e praktiakve mësimore në mjediset klinike etj. Sondazhet zhvillohen në respekt të anonimatit dhe kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>11. Pyetësorët e studentëve-model; 8. Raport i NJSBC; 18. Rregullore e praktikave; Analiza e gjurmimit të studentëve për vitin akademik 2018-2023.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>UAL monitoron dhe vlerëson përmes NJSBC në mënyrë periodike programin e studimit BSc. Fizioterapi. Për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit, UAL përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta vlerësimi. Shembuj të këtyre metodave janë pyetësorët e studentëve për vlerësimin e mësimdhënies, rezultatet e arritura nga provimi VAP për licensimin, gjurmimi i Alumni, vlerësimi i studentëve për aftësitë praktike nga mbikëqyrësi i praktikës mësimore në mjediset klinike, intervistat me studentët etj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.4**




**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>NJSBC, njësia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në UAL, ka në përbërje të saj anëtar nga çdo fakultet i universitetit, një ekspert të jashtëm dhe një përfaqësues nga studentët. Në procesin e sigurimit të cilësisë janë të përfshirë aktivisht stafi i angazhuar në pritjen e studentëve, tutorët akademik, përgjegjësit e programit, sekretaria mësimore, drejtuesit e njësive bazë, drejtuesi i njësisë kryesore. Të gjithë aktorët e përfshirë janë në kontakt të vazhdueshëm dhe bashkëpunim të ngushtë me studentët që ndjekin programin e studimit BSc. Fizioterapi dhe stafin akademik të angazhuar në programin e studimit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.3. Rregullore e NJSBC;</i></p> <p><i>23. Tabelat e të dhënave për programin e studimit, Tabela 9.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Anëtarët e grupeve vjetore të punës së NJSBC janë pedagogë të brendshëm dhe përfaqësues të departamenteve përgjegjës për programet e studimit. Ata janë të lidhur ngushtë me mësimdhënien dhe studentët, kështu që raportimi i problematikave dhe nevojave në lidhje me mësimdhënien dhe mësimnxënien është i garantuar.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.3. Rregullore e NJSBC;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të NJSBC, stafin akademik, drejtuesin e njësisë bazë dhe studentë.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe</p>	<p>Institucioni nëpërmjet akteve të brendshme përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë bazë dhe kryesore përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ, studentët dhe gjithë palët e përfshira në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në aktet rregullatore të brendshme të UAL si Statuti dhe Rregullorja e UAL, përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat konkrete që ka secili nga aktorët në proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Përbërja e njësive të sigurimit të cilësisë si NJSBC nga personel akademik dhe përfaqësues të studentëve, mundëson një bashkëpunim më</p>






<p>studentëve e programit të studimit.</p>	<p>të mirë të kësaj njësie me personelin akademik dhe studentët në proceset evlerësimit të programeve të studimit. Ky bashkëpunim ka lehtësuar procesete vlerësimit të brendshëm të cilësisë si vlerësimi i performancës së stafit, vlerësimi nga studentët i programit të studimit etj.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>3.3. Rregullore e NJSBC;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të NJSBC, stafin akademik, drejtuesin e njësisë bazë, kryesore, studentët dhe GVB.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në UAL, përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Grupet përkatëse që ngrihen në nivel njësie, bazuar në statutin e institucionit janë të pavarura dhe autonome. Ato vlerësojnë periodikisht cilësinë dhe efikasitetin e veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore të stafit, performancën akademike të studentëve dhe aktivitetin administrativ të institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>1. Statuti i Universitetit Aldent;</i></p> <p><i>3.3. Rregullore e NJSBC;</i></p> <p><i>Vizita në intitucion, takimi me përfaqësues të NJSBC, stafin akademik, drejtuesin e njësisë bazë, kryesore, studentët dhe GVB.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>UAL në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë bën pjesë aktive edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit BSc. Fizioterapi. Në kuadër të përmbushjes së këtij kriteri, në grupin e anëtarëve të NJSBC është dhe një ekspert i jashtëm. Ndërkohë që për zhvillimin dhe analizimin e pyetësorit të studentëve, UAL bashkëpunon prej vitesh me Institutin për Cilësi në Arsim. Ekspertizë e vlefshme merret edhe nga kompanitë e trajnimit dhe punësimit ndërkombëtar që vijnë në institucion, shkëmbimet e stafit dhe bashkëpunimet ndërinstitucionale.</p> <p><b>Evidenca:</b></p>




	3.3. Rregullore e NJSBC; Vizita në intitucion, takimi me përfaqësues të NJSBC, stafin akademik, administrativ, drejtuesin e njësisë bazë dhe kryesore.			
<b>Konkluzione</b>	UAL përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit BSc. Fizioterapi dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. Në përmbushje të këtij procesi, Departamenti i Infermierisë dhe Fizoterapisë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në bashkëpunim edhe me ekspertë të jashtëm, shkëmbimin e praktikave më të mira nga mobilitetet dhe bashkëpunimet ndërinstytucionale siguron gjithëpërfshirje në realizimin e këtij procesi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit BSc. Fizoterapi janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Vizioni dhe qasja e UAL në lidhje me procesin e SBC janë pjesë e planit strategjik të institucionit. Raporti vjetor i veprimtarive të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies është publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë si pjesë integrale edhe e raportit vjetor institucional.  <b>Evidenca:</b> 2. <i>Strategjia e UAL;</i> 8. <i>Raport i NJSBC.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe	Referuar RVB-seë, raporti vjetor i NJSBC për rezultatet e vlerësimit të programit të studimit nga studentët publikohet çdo fund viti akademik dhe i përcillet senatit akademik për miratim. Raporti i detajuar i dorëzohet Rektorit, ndërkohë që në respekt të etikës akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale publikohet pa emra apo element të tjerë identifikues




<p>legjislaconin për të dhënat personale.</p>	<p>raporti i përmbledhur. Gjetjet problematike komunikohen në mënyrë individuale.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>8. Raport i NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Raporti vjetor i NJSBC, i hartuar në kuadër të veprimtarive për sigurimin e cilësisë, përvec rezultateve dhe analizës së të dhënave përmban edhe një plan masash për adresim të problematikave të hasura. Raporti bashkë me planin e masave diskutohet dhe miratohet në senatin akademik, i cili nxjerr në formën e vendimeve masat që merren për përmirësim.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>8. Raport i NJSBC;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Vendimet që merren në kuadër të masave për përmirësim të cilësisë së mësimdhënies në UAL, vlerësohen për implementimin dhe monitorimin nga Senati Akademik. Efektiviteti i masave vlerësohet edhe nga drejtuesit e njësive bazë, të cilët raportojnë në departament në kuadër të takimeve periodike dhe çdo fundviti akademik. Drejtuesit e njësive bazë në raportin vjetor të njësisë, pasqyrojnë edhe efikasitetin e masave të marra në funksion të përmirësimit të tyre.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>8. Raport i NJSBC;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesin e njësisë bazë.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UAL organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimeve përfshirë dhe programin BSc.Fizioterapi. Këto veprimtari organizohen në bashkëpunim të ngushtë nga NJSBC, shërbimi i tutoriatit akademik dhe përgjegjësi i programit të studimit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>23. Tabela 17. Aktivitetet e stafit;</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me përfaqësues të NJSBC.</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>UAL dëshmon me qasjen, vizionin dhe strategjinë zhvillimore gadishmërinë për krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë. Politikat, proceset dhe veprimtaritë për SBC për programin e studimit BSc. Fizoterapi janë publike dhe transparente. Raportet e hartuara në kuadër të këtyre veprimtarive janë publike dhe diskutohen në çdo njësi të institucionit në veprimtari periodike që UAL organizon për informimin dhe ndërgjegjësimin studentëve, stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhaur për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
--------------------	---	--	--	--

<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Fizioterapi”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Plotësimi i kuotave në këtë program studimi;
2. Numër i lart bashkëpunimesh me klinika private për zhvillimin e praktikave profesionale;
3. UAL ka përfshirë ekspert të jashtëm në funksion të përmirësimit të cilësisë;
4. Organizimi i orëve të hapura dhe relacionet që përgatit stafi akademik në momentin e përfundimit të një mobiliteti;
5. Kryerja e ekzaminimeve dhe vizitave shëndetësore për stafin akademik falas një herë në vit dhe ulje të tarifës së shërbimeve gjatë gjithë vitit;
6. Mundësia që studentët dhe stafi akademik i UAL ka në shfrytëzimin pa limit dhe pa pagesë të literaturës mjekësore nëpërmjet bibliotekës Hinari;

**b. Pika të dobta:**

1. Plani mësimor nuk përfshihet në rregulloren e programit të studimit; *(Standarti II.3, Kriteri 2)*
2. Mungesa e një rregullore specifike për provimin e përgjithshëm përfundimtar; *(Standarti III.5, Kriteri 1)*
3. Numër i ulët i mobiliteteve të studentëve në IAL të huaja; *(Standarti II.4, Kriteri 4; Standarti III.4, Kriteri 4)*

**Rekomandime:**

1. Të përfshihet në Rregulloren e programit të studimit plani mësimor për programin Bachelor në Fizioterapi;
2. Të rritet numri i mobiliteteve të studentëve në IAL jashtë Shqipërisë;
3. UAL të hartoj një Rregullore specifike për provimin e përgjithshëm përfundimtar (diplomimin e studentëve);
4. Standardizim të procedurës së përditësimit të programit të studimit si dhe dokumentim i përfshirjes së studentëve alumni, Urdhërit të Infermierit dhe shoqatave profesionale të tjera;
5. Hartimi i raporteve analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit që UAL ka me IAL jashtë Shqipërisë;
6. Hartimi i udhëzues të vecantë që lidhen me metodat të ndryshme innovative të mësimdhënies, si edukimi simulator, imersiv etj.



## Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Physiotherapy"

### **a. Strengths and affirmations:**

1. Completing the quotas in this study program;
2. A high number of collaborations with private clinics for the development of professional practices;
3. UAL has included an external expert to improve quality;
4. The academic staff organizes open hours and prepares relations at the end of a mobility program.
5. Offering free examinations and health checks for academic staff once a year and low service fees throughout the year.
6. The opportunity that students and academic staff of UAL have in the unlimited and free use of medical literature through the Hinari library;

### **b. Weaknesses:**

1. The curriculum is not included in the regulation of the study program; (*Standart II.3, Criterion 2*);
2. Lack of specific regulation for the final general exam; (*Standart III.5, Criterion 1*)
3. Low number of students mobilities in foreign HEIs; (*Standart II.4, Criterion 4; Standart III.4, Criterion 4*)

### **Recommendation**

1. To include in the regulations of the study program the teaching plan for the Bachelor program in Physiotherapy;
2. To increase the number of students mobilities in HEIs outside Albania;
3. UAL should draft a specific regulation for the general final exam (graduation of students);
4. Standardization of the procedure for updating the study program as well as documenting the involvement of alumni students, the Order of Nurses, and other professional associations;
5. Drafting analytical reports of benefits from cooperation agreements that UAL has with HEIs outside Albania;
6. Drafting of special guidelines related to different innovative teaching methods, such as simulator education, immersive education, etc;



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X